

20


RAPORTI VJETOR

24

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe
Shërbimeve Shoqërore



PUNËSIM, FORMALIZIM, SIGURI, SHËNDET



PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	3
2. HYRJE	6
- Misioni	6
- Deklarata e misionit	6
- Detyrat e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	6
3. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	8
4. ARRITJET KRYESORE	10
- Përgjegjësi specifike	11
5. RAPORTIME SIPAS SEKTORËVE	15
Drejtoria e Inspektimit të Punës	15
- Sektori i Analizës së Riskut	16
- Sektori i Mbykqyrjes për Marrëdhëniet e Punës	18
- Sektori i Mbykqyrjes për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë	21
- Sektori i Statistikës	23
Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	40
- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme	40
- Sektori i Çështjeve Ligjore	42
- Sektori i Financës	46
Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore	48
6. AKTIVITETE DHE PUBLIKIME	53
- Marrëveshje/Takime/Evente	54
7. SFIDA TË HASURA	59
8. OBJEKTIVAT	61

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME



1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shër bimeve Shoqërore, në raportin e tij vjetor 2024, paraqet në mënyrë të përmbledhur treguesit e inspektimit, arritjet, zhvillimet teknologjike dhe sfidat e inspektimit të punës në Shqipëri. Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti bazohet në të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, duke u mbështetur në metodologjitë bashkëkohore për marrjen e informacionit, përpunimin e të dhënave dhe zhvillimin e analizave teknike të thelluara.

Misioni i ISHPSHSH është të garantojë vende pune të denja, të sigurta dhe të shëndetshme nëpërmjet një sistemi inspektimi profesional dhe të përgjegjshëm, si dhe të promovojë një kulturë në zbatim të legjislacionit të punës në të gjithë vendin. Sistemi i inspektimit vazhdon të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, falë rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, rritjes së cilësisë së inspektimit mbi bazë risku dhe zhvillimit të sistemeve inovative për vlerësimin e inspektimeve.

Viti 2024 ka shënuar një sërë arritjesh të rëndësishme për ISHPSHSH, duke sjellë rezultate inkurajuese për inspektimin e punës në Shqipëri. Një nga arritjet kryesore është lancimi dhe pilotimi me sukses i sistemit *MIRA -Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut*, një sistem inteligjent zhvilluar nga Inspektorati Shtetëror i Punës, me mbështetjen e ILO dhe financim të Bashkimit Europian, një platformë inovative që ka modernizuar inspektimin e punës në Shqipëri. Duke përdorur teknologji të avancuara të analizës së të dhënave dhe *inteligjencës artificiale, si data mining dhe machine learning*, MIRA ka sjellur një qasje të re në planifikimin e inspektimeve, duke përdorur koeficientët e riskut bazuar në analizën e të dhënave historike. Kjo mundëson evidentimin e subjekteve me risk të lartë dhe identifikimin e zonave ku mund të ndodhë punë e padëklaruar ose shkelje të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Gjithashtu, MIRA synon të orientojë inspektorët drejt vendimmarrjeve objektive dhe të unifikuara sipas standardeve ligjore, të priorizojë inspektimet bazuar në risk, si dhe të ndërgjegjësojë punëdhënësit mbi detyrimet ligjore, duke nxitur përputhshmërinë me legjislacionin e punës.

Gjatë vitit 2024 u inspektuan **190,340** vende pune në **9,860 subjekte**, me një rritje të dukshme të inspektimeve në subjekte të reja në masën **22%** të total inspektimeve të realizuara. Kjo rritje e vazhdueshme ka ardhur si rezultat i planifikimit mbi bazë risku dhe bashkëpunimit të përmirësuar me institucionet dhe partnerët si DPT dhe QKB. Një fokus i veçantë iu kushtua zbatimit të ligjeve për punëmarrësit nën 18 vjeç, të huajt, personat me aftësi ndryshe dhe gratë shtatzëna.

Informaliteti i shfaqur në të gjitha format e tij ka qenë në qendër të proceseve inspektuese me fokus të shtuar në sektorë të veçantë. Janë konstatuar **2600 punëmarrës informal, 1,058** ose **32%** më shumë se një vit më parë, për të cilët është formalizuar marrëdhënia e punësimit brenda procesit inspektues, përmes masave ligjore të marra nga inspektorët e punës. Janë konstatuar të punojnë **3952 punëmarrës pa kontrata** individuale ose **58% më shumë** se viti 2023. Mungesa e kontratës së punës, si një nga elementët kryesorë të informalitetit gri në një marrëdhënie punësimit ka qenë në qendër të orientimit të planifikimit me bazë risku gjeneruar nga sistemi digjital MIRA. Rezultatet nga formalizimi i punëmarrësve informal përllëgariten rreth **28,536,000 lekë/muaj kontribut i shtuar** në skemën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që krahasimisht me mesataren e tre viteve të fundit është 11,807,280 lekë më shumë vetëm në 1 muaj.

Në lidhje me sanksionet, për shkeljet flagrante, të rënda ose të përsëritura, janë vendosur **210 gjoba** me vlerë **53,790,000 lekë**, një rritje prej **42%** në numër dhe **25%** në vlerë krahasuar me vitin e kaluar. Vetëm 21 % e gjobave u ankimuan, shifër kjo më e ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Gjykata ka **lënë në fuqi 100%** të vendimeve të inspektimit dhe 45% e gjobave janë likuiduar vullnetarisht, 10% më shumë se vitin e kaluar, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së vendimmarrjes së inspektorëve.

Edhe gjatë vitit 2024, ka vazhduar trendi në ulje i vendimeve përfundimtare të ankimuarra administrativisht dhe e ankimimeve kundër gjobave, duke reflektuar rritjen e besimit të subjekteve në procesin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e komunikimit dhe transparencës institucionale. Vetëm **21%** e vendimeve me gjobë u ankimuan, një shifër më e ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Trupa kolegjiale e ISHPSHSH shqyrtoi të gjitha ankimimet brenda afateve ligjore, duke lënë në fuqi 46 vendime inspektimi, duke ndryshuar 7 dhe pa asnjë vendim të shfuqizuar. Nga 20 vendimet e ankimuar në Gjykatë, në 100% të rasteve vendimet e Komisionit të Ankimit u mbështetën nga gjykata.

Janë depozituar **920** ankesa/kërkesa, **127 më shumë** se një vit më parë. Këto ankesa janë trajtuar përmes proceseve të rregullta inspektuese, kryesisht për shkelje të të drejtave të punëmarrësve, si mospagesa për punën në ditët e festave, pushimet javore, orët shtesë dhe mungesa e kontratave të punës. Këtë vit, **77% e ankesave** janë zgjidhur në favor të punëmarrësve, **4% më shumë** se mesatarja e tre viteve të fundit. Gjithashtu, 100% e kërkesave për sqarime ligjore kanë marrë përgjigje, duke ndihmuar në qartësimin e situatave dhe zbutjen e konflikteve potenciale.

Të dhënat statistikore për **aksidentet në punë** gjatë vitit 2024 tregojnë një numër të qëndrueshëm krahasuar me vitet e mëparshme, me *177 raste të klasifikuara si aksidente pune*, përfshirë *33 humbje jete*. Sektori i ndërtimit mbetet më i rrezikuari me 24% të aksidenteve, duke reflektuar zhvillimin e shpejtë të këtij sektori me 1,019 kantiere leje ndërtimi të lëshuara në vitin 2024 sipas INSTAT. Pavarësisht kontrolleve intensive nga ISHPSHSH, aksidentet në këtë sektor vazhdojnë të jenë një sfidë. Është e domosdoshme forcimi i sistemeve të sigurisë dhe shëndetit në nivel ndërmarrjeje, veçanërisht për rolin e Koordinatorit të Sigurisë dhe ndërgjegjësimin e punëdhënësve për zbatimin korrekt të ligjit. Sektori “Miniera-Kariera” përfaqëson 18% të aksidenteve, duke mbetur një nga sektorët me risk shumë të lartë. Inspektimet në nëntokë janë kompetencë e AKSEM, me të cilin ISHPSHSH bashkëpunon për trajtimin e aksidenteve në këtë sektor.

Në vitin 2024, ISHPSHSH ka luajtur një rol kyç në hartimin e strategjive, planeve të veprimit dhe raportimeve në *Progres-Raportin e integritit në BE*, për Kapitujt 19, 20, 2, 23, 24 dhe 28, si dhe disa nenkomitete. Institucioni ka përmbushur detyrimet e raportimit periodik ndaj institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare si *ILO, Kombet e Bashkuara/CESCR, Departamenti Amerikan i Shtetit* për raportin e trafikimit të personave dhe punës së fëmijëve, Komiteti për të Drejtat e Njeriut për UPR dhe komitetet monitoruese sektoriale. Kontributet e ISHPSHSH janë dhënë në mënyrë të plotë, të qartë dhe brenda afateve të përcaktuara.

Gjithashtu ISHPSHSH-ja është pjesë e institucioneve të përfshira me objektiva dhe detyra konkrete në dokumente strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale, konkretisht:

- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030
- Dokumenti Politik i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 2024-2030.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025.
- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024–2026.
- Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025
- Strategjia afatmesme e të ardhurave dhe plani i veprimit, 2024-2027.
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030

Komunikimi dhe informimi publik përbëjnë një shtyllë kyçe për të siguruar transparencë dhe për të ndërtuar marrëdhënie të besueshme me publikun lidhur me aktivitetin e ISHPSHSH. Gjatë vitit 2024, institucioni ka zbatuar një sërë fushatash të targetuara dhe të koordinuara me partnerë të rëndësishëm, si MEKI, Agjencia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), ILO dhe organizata të tjera, për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe detyrimet e punonjësve. Përmes këtyre fushatave dhe materialeve multimediale të shpërndara në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale, ISHPSHSH ka informuar publikun mbi rëndësinë e respektimit të legjislacionit të punës dhe rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke promovuar një ambient pune të sigurt dhe dinjitoz për të gjithë. Një arritje e rëndësishme ka qenë edhe informimi i 16,396 subjekteve të reja përmes platformës e-Albania mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i punës, falë bashkëpunimit të frytshëm me QKB-në. Këto iniciativa kanë ndihmuar në ngritjen e vetëdijes dhe respektimin e standardeve ligjore në vendin e punës.



Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore luan një rol thelbësor në monitorimin dhe inspektimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore, duke siguruar që këto subjekte të respektojnë standardet ligjore dhe të ofrojnë shërbime cilësore për përfituesit. Në vitin 2024, kjo drejtori ka intensifikuar përpjekjet për të garantuar përputhshmërinë me ligjin përmes **126 inspektimeve në qendrat e përkujdesit shoqëror** në të gjithë vendin. Veprimtaria e saj përfshin jo vetëm inspektimin e ankesave dhe kërkesave nga përfituesit dhe institucionet që mbrojnë të drejtat e njeriut, por edhe vlerësimin e kriterëve për licencimin e subjekteve të reja. Një hap i rëndësishëm gjatë vitit 2024 ka qenë propozimi për **revokimin e licencës së 4 subjekteve jopublike**, të cilat nuk plotësonin standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të kujdesit komunitar. Kjo masë administrative nënvizon angazhimin e ISHPSHSH për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e përfituesve dhe për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë me legjislacionin në fushën e shërbimeve sociale.

2.HYRJE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është autoriteti shtetëror i ngarkuar me funksionet e inspektimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore. Raporti i analizës vjetore hartohet bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe përmbledh aktivitetet dhe arritjet e realizuara gjatë vitit 2024. Veprimtaria inspektuese shtrihet dhe organizohet në të gjithë territorin e vendit përmes gjashtë Drejtorive Rajonale që kanë në përbërje të tyre 13 sektorë. Procedurat inspektuese kryhen online nëpërmjet sistemit "e-inspektimi", në kohë reale dhe në prani të subjektit të inspektuar. Referuar të dhënave të INSTAT (publikuar më 04.06.2024), numri i subjekteve aktive në Shqipëri është rreth 226,778, ndër të cilat 96,440 janë fermerë të pajisur me NIPT, të cilët nuk janë në fokusin kryesor të inspektimit të punës. ISHPSHSH luan një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve, promovimin e ambienteve të punës të sigurt dhe të shëndetshme, si dhe në sigurimin që ofruerit e shërbimeve shoqërore të përmbushin standarde.

Misioni

Misioni i ISHPSHSH është të sigurojë respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të punës në vendin e punës. Inspektorati kryen inspektime dhe kontrole për të siguruar kushte të sigurt dhe të shëndetshme të punës, pagesa të drejta dhe orar të rregullt të punës. Përmes masave administrative dhe këshillimit, Inspektorati promovon njohuritë dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve dhe punëdhënësve sipas ligjeve të punës, duke synuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurimin e mirëqenies së punëtorëve në të gjitha sektorët.

Deklarata e misionit


Të garantojë vende pune të denja, të sigurt dhe të shëndetshme nëpërmjet një sistemi inspektimi profesional, të përgjegjshëm, si dhe të promovojë një kulturë në zbatim të legjislacionit të punës.

Detyrat e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

ISHPSHSH në zbatim të ligjit nr 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës” (i ndryshuar me ligjin nr. 57/2017) ka përgjegjësi të sigurojë:

- a) zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, përfshirë kohën e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë që inspektorët e punës janë ngarkuar të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;
- b) ofrimin e informacionit teknik dhe këshillave për punëdhënësit dhe punëmarrësit në lidhje me mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore që mbulojnë çështjet e punës;
- c) sjellje në dijeni të autoriteteve përgjegjëse për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulojnë në mënyrë të specifike nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë masat dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e situatës.

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA



3. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

ISHPSHSH si institucion ekzekutiv ka si qëllim garantimin e veprimtarisë inspektuese të inspektorëve të punës në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat që ka institucioni.

- Rritja e efektivitetit të procesit të inspektimit të punës, për të siguruar zbatimin e ligjit nga subjektet në të gjithë vendin
- Identifikimi i punësimit jo në përputhje me ligjin dhe adresim i tyre apo referimi pranë institucioneve përgjegjëse
- Monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm i cilësisë së procesit të inspektimit që kryhet nga trupa inspektuese.
- Zhvillimi sistemeve digjitale për të rritur profesionalizmin dhe për të mbështetur teknikisht inspektimin e punës
- Sigurimi i transparencës dhe integritetit institucional gjatë procesit të inspektimit
- Promovimi i një kulture parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe produktive përmes fushatave këshillimore dhe përdorimit efektiv të kanaleve digjitale

Raporti vjetor i ISHPSHSH-së për vitin 2024 paraqet në mënyrë të përmbledhur treguesit e inspektimit, arritjet, dhe problematikat që kanë ndodhur gjatë punës së trupës inspektuese gjatë këtij viti. Raporti përmban konkluzione për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit përmes hartimit të objektivave të qarta për vitin 2024. Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti bazohet në të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, identifikimin e problematikave përmes analizës së gjetjeve, konsultimin me legjislacionin në lidhje me zbatimin e tij në praktikë, si dhe zhvillimin e platformave inovative. Të dhënat e inspektimit përfshijnë instrumentat e **fushës së punës** realizuar nga 6 Drejtoritë Rajonale sic janë;

- numrin e inspektimeve të realizuar nga çdo inspektor pune,
- llojit të inspekitimit të kryer,
- llojit të aktivitetit ekonomik,
- numrit të aksidenteve në punë,
- numri i ankesave,
- informaliteti në të gjitha format e tij,
- punësim kategorish të veçantë punëmarrësish (të mitur, të huaj)
- shkeljeve të dispozitave ligjore,
- masave administrative

Instrumentat e **fushës së shërbimeve shoqërore** ku përfshihen,

- të dhëna për kapacitetet e qendrave të përkujdesit,
- pyetësor për menaxherët dhe drejtues të qendrave,
- pyetësor për punonjësit social,
- intervistat me përfituesit,
- Identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve duke parë krahasimisht trendin pozitiv dhe negativ të çështjeve specifike, që reflektojnë nga njëra anë nivelin e zbatimit të legjislacionit të punës nga punëdhënësit në aktivitetet ekonomike të tyre dhe nga ana tjetër ato të standarteve të shërbimeve shoqërore në qendrat e përkujdesjes sociale.
- Konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, duke identifikuar çështjet apo situatë që nuk mbulohen shprehimisht nga ligji apo vetë situata dhe rrethanat e bëjnë të pa zbatueshme në praktikë një dispozitë ligjore. Për të dyja konstatimet, evidentim të adresimit të problematikës/ave në autoritetin përgjegjës.
- Zhvillimin e metodologjive, platformave inovative, duke evidentuar arsyet, qëllimin dhe çfarë synohet përmes zhvillimit të tyre.

The image shows two men in a construction setting. They are wearing white hard hats and orange safety vests over light-colored shirts. They are leaning over a table, looking at a laptop. The background is a blurred construction site with yellow scaffolding. The entire image has a semi-transparent red overlay. The text 'ARRITJET KRYESORE' is written in large, bold, white capital letters with a slight shadow effect, positioned in the lower-left quadrant of the image.

ARRITJET KRYESORE

4. ARRITJET KRYESORE

Gjatë vitit 2024, janë inspektuar **190,340 vende pune**, ose marrëdhënie punësimi të verifikuara në **9,860 subjekte** të inspektuara duke shënuar **1%** më shumë inspektime se e njëjta periudhë e një viti më parë (edhe pse numri i pozicioneve vakante është 10 inspektor terreni), treguesit e inspektimit kanë rezultuar në rritje cilësore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku më konkretisht:

- ✓ Lancimi dhe pilotimi me sukses i sistemit **MIRA - Matrica e Inteligjencës** dhe Analizës së Riskut, një platformë e avancuar digjitale e mbështur në teknologji të avancuar si “Data Mining” dhe “Machine Learning” ka mundur automatizimin e procesit të vendimmarrjes dhe atë të planifikimit në bazë të rrezikut. Automatizimi i procesit mundëson një bazë të përmirësuar të dhënash të cilat shërbejnë në identifikim të problematikave të zbatimit të dispozitave ligjore, apo në përcaktim të sektorëve/ çështjeve që kanë nevojë për ndërhyrje.
- ✓ Zgjerimi i hartës së subjekteve që inspektohen për herë të parë në masën **22%** të total inspektimeve të realizuara duke shënuar një rritje me 2% më shumë se mesatarja e tre viteve të fundit.
- ✓ Janë konstatuar **2,600** punëmarrës informal ose **32 %** më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, nga të cilët për **2,575** prej tyre është formalizuar marrëdhënia e punësimit brenda procesit inspektues, përmes masave ligjore të marra nga inspektorët.
- ✓ Janë konstatuar të punojnë **3,952** punëmarrës pa kontrata individuale ose 58 % më shumë se konstatimi i vitit 2023. Mungesa e kontratës së punës, si një nga elementët kryesorë të informalitetit gri në një marrëdhënie punësimi ka qënë në qendër të orientimit të planifikimit me bazë rrisht gjeneruar nga sistemi analizës së rrisht (MIRA)
- ✓ Vëmendje ka pasur dhe kontrolli i marrëdhënieve dhe kushteve të punës për kategoritë e veçanta të punëmarrësve “Nën 18 vjeç” dhe “PAK”, e ku rezultojnë;
 - 124 punëmarrës nën 18 vjeç ose 42 % më pak se një vit më parë të konstatuar në punë dhe verifikuar
 - 1,536 punëmarrës të huaj ose 14 % punëmarrës më shumë, krahasuar me vitin 2023
- ✓ **118 %** janë dënime administrative për inspektime për aksident në punë, ku ka subjekte ku është marrë më shumë se një masë.
- ✓ Depozituar në total **920 ankesa/kërkesa**, **127 më shumë** se një vit më parë të cilat janë trajtuar kryesisht përmes proceseve të mirëfillta të inspektimit. **77% e ankesave** ose **4% më shumë** janë zgjidhur në favor të punëmarrësve këtë vit krahasimisht me 73 % që është mesatarja e tre viteve të fundit.
- ✓ 100% e kërkesave për sqarime ligjore kanë marrë përgjigje, duke ndikuar në qartësimin e situatave dhe indirekt në zbutjen e konflikteve potenciale.
- ✓ **61 %** e inspektimeve për ankesë në punë kanë shkuar me masa administrative.
- ✓ **210** gjoba me vlerë **53,770,000 lekë** janë vendosur nga inspektorët e punës në raste të evidentimit të shkeljeve të rënda, ku krahasimisht me një vit më parë kemi një rritje të konsiderueshme me **42% më shumë** në numër gjobash dhe **25% më shumë** në vlerë.
- ✓ Vetëm **21% e dënimeve me gjobë** janë ankimuar administrativisht pranë Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së, **11% më pak** krahasuar me mesataren e tre viteve të fundit.
- ✓ **100% të çështjeve** për vendimet e inspektimit për të cilat gjykata është shprehur, janë lënë në fuqi në favor të ISHPSHSH-së
- ✓ 45% e gjobave janë likuiduar vullnetarisht nga subjektet me 10% më shumë se një vit më parë, duke reflektuar përmirësimin cilësor të vendimmarrjes së inspektorëve.

- ✓ **17,501** subjekte të reja të regjistruara në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit) që janë këshilluar për të drejtat dhe detyrimet mbi Legjislacionin e Punës
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve kundrejt detyrimeve ligjore, ku tashmë pjesë e njoftimeve bëhen jo vetëm aksidentet, por dhe incidentet në punë (aksidente pa pasoja në njerëz). Për vitin 2024 rezultojnë 3 incidente në punë të deklaruara pranë ISHPSHSH-së.
- ✓ Nën sloganin “Vende Pune të shëndetshme, në Epokën Dixhitale”, u realizua fushata e udhëhequr nga Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (EU-OSHA) me synimin rritjen ndërgjegjësimit për ndikimin e teknologjive dixhitale në vendin e punës dhe mënyrat për të menaxhuar këto ndryshime. Në **36 subjekte ndërtimi u informuan 1,050** punëmarrës, ndërsa në subjekte të tjera si prodhim, call- center, shërbime etj, ku automatizimi i detyrave, përmirësimi i teknologjisë, përdorimi i platformave dixhitale është përfqafuar, u kryen **45 vizita inspektuese dhe u informuan 2,987** punëmarrës.
- ✓ Realizimi i buxhetit për vitin 2024 në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është në masën **90%**, rezultat që ka ardhur për shkak të problematikave procedurale të hasura gjatë vitit 2024 në realizimin e shpenzimeve kapitale, konkretisht në projektin Blerje Automjete, për të cilin nuk u bë e mundur realizimi në masën 100%, pavarësisht angazhimit maksimal të institucionit për finalizimin e këtij projekti me sukses.

Përgjegjësi Specifike

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore siguron informacion të përditësuar për fushën e inspektimit në punë, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna statistikore mbi kushtet e punës së denjë, hetimin e aksidenteve në punë, mbrojtjen e punëmarrësve, ligjshmërinë në orarin e punës, pagesën konform legjislacionit, sigurimin e punëmarrësve, higjienën dhe mirëqenien në vendin e punës, punësimin e ligjshëm të fëmijëve, të drejtat dhe detyrimet nga kontrata e punës, zbatimin e marrëveshjeve kolektive dhe çështje të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin.

ISHPSHSH bashkëpunon me Autoritetet e tjera ligjzbatuese dhe Organizata Kombëtare dhe Ndërkombëtare, për çështje që janë pjesë e fushës së kompetencës. Në këtë kuadër gjatë vitit 2024 mund të cilësojmë vijimin e punës me/përmes;

- Memorandumit të Bashkëpunimit me **Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT)**- për shkëmbimin e informacionit të të punësuarve për çështje të kontrollit të informalitetit
- Memorandumit të Bashkëpunimit me **Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)** - Informimi i subjekteve të reja në kohë reale nëpërmjet e-Albania mbi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga Legjislacioni i Punës.
- **Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)**- për shkëmbimin e informacionit për çështje të përbashkëta kryesisht, punëmarrësit e huaj.
- Memorandumit të Bashkëpunimit me **Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)**- për shkëmbimin e informacionit periodik në lidhje me subjektet që rezultojnë me gjobë, me qëllim përjashtim të tyre nga pjesëmarrja në tendera.
- Memorandumit të Bashkëpunimit me **Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)**- për ndërveprim me qëllim parandalimin, reduktimin dhe adresimin e mosbarazisë dhe diskriminimit.

- Organizatave Joqeveritare Ndërkombëtare dhe Lokale që punojnë në fushën e të drejtave të punës si *ILO, ESAP, GIZ, Expertise France/AFD; AOSD, CLR, GADC*, etj.



Përfshirje dhe angazhim në hartimin e strategjive, plan veprimeve dhe raportimeve në Progres-Raport në kudër të procesit të integritimit në BE, etj. më konkretisht në:

- Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi"Kapitulli
- Kapitulli 20 "Ndërrmarjet dhe Politikat Industriale"
- Kapitulli 2 "Lëvizja e Lirë e Punëtorëve"
- Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"
- Kapitulli 24 "Drejtësia, Liria, Siguria"
- Kapitulli 28 "Mbrotjtja e konsumatorit dhe shëndetit"
- Nënkomitetin Inovacioni dhe Shoqëria e Informacionit
- Nënkomitetin Drejtësi, Liri, Siguri etj.

ISHPSHSH gjithashtu ka detyrim për raportim periodik në një numër të kosideruesem institucionesh, organizatash dhe komitetesh të cilësuaru më poshtë ku kontributi i ISHPSHSH është dhënë në mënyrë të plotë, të qartë dhe brenda afateve të kërkuara. Konkretisht:

- ILO (Organizatën Ndërkombëtare të Punës).
- UN / Kombet e Bashkuara/ CESC-së, Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore).
- DASH (Departamentin e Shtetit Amerikan) për Raportin e Trafikimit të Personave si dhe format e këqija të punës së fëmijëve.
- KDNJ (Komiteti për të Drejtat e Njeriut), për Raportin e Rishikimit Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë dhe rekomandimet e dhëna.
- Komitetet Monitoruese Sektoriale.
- Koordinatorit Kombëtar për çështje të luftës kundër trafikimit të personave.






**PUNË TË DENJË,
STANDARDE, SIGURI
DHE SHËNDET
PËR ÇDO PUNONJËS**

5. RAPORTIME SIPAS SEKTORËVE

Përbërja organizative dhe Organigrama

ISHPSHSH, si pjesë e administratës publike funksionon mbështetur në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Struktura e miratuar bazuar në Urdhrin nr. 174, datë 10.09.2024 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, është e organizuar në dy nivele: qendror dhe rajonal. Struktura ka në përbërje të saj 163 punonjës, në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 6 Drejtori Rajonale.



DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PUNËS

Drejtorja e Inspektimit të Punës menaxhon dhe mbikqyr të gjithë procesin e inspektimit të punës, për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore që mbulojnë fushën e punës. Siguron dhe promovon një kulturë parandaluese në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të pasur vende pune të sigurta, të shëndetshëm e produktive. Analizon të dhënat e inspektimit të punës sipas llojit të aktiviteteve ekonomike, duke orientuar planifikim të inspektimeve mbi bazë risku për drejtoritë rajonale, mban marrëdhënie me publikun, adreson problemet dhe ankesat, aksidentet në punë dhe çështjet e marrëdhënive të punës dhe të sigurisë e shëndetit në punë duke u siguruar që çështjet të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Puna e kësaj drejtorie menaxhohet nga sektorët teknikë të cilët mbikqyrin, administrojnë dhe trajtojnë çështje specifike që lidhen me inspektimin e punës dhe ka në përbërje të saj 4 sektore: 1) Saktori i Analizës se Riskut; 2) Saktori i

Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës; 3) Sektori i Mbikëqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë; dhe 4) Sektori i Statistikës.

Sektori i Analizës së Riskut

Sektori i Analizës së Riskut (SAR) si pjesë e Drejtorisë së Inspektimit, ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të inspektimit. Ky sektor:

1. asiston dhe mbikqyr procesin e programimit të inspektimit të punës në nivel rajonal,
2. ka ndikimin e vet në mikëqyrjen e cilësisë së procesit të inspektimit në tërësi për gjithë strukturën inspektuese,
3. sigurohet për administrimin, funksionimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të platformave digjitale që përdoren nga inspektorët e punës.

Planifikimi i Inspektimit

Planifikimi i inspektimit në ISHPSHSH për vitin 2024 është kryer sipas rregullave dhe standardeve ligjore, me një fokus të veçantë në procesin e planifikimit mbi bazë risku. ISHPSHSH harton plane mujore inspektimi duke përdorur metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe sistemin RAS të platformës MIRA, i cili automatizon planifikimin bazuar në historikun e inspektimeve dhe identifikimin e sektorëve me nevojë për ndërhyrje. Objektivat e planifikimit për 2024 përfshijnë:

1. Inspektime, në subjekte ekonomike me risk potencial për mos zbatimin e dispozitave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë, kryesisht aktivitetet e ndertimit dhe subjekte me risk të lartë, për sigurinë në punë, për shkak të aktivitetit që kryejnë.
2. Inspektime, në subjekte ekonomike me risk potencial për mos zbatimin e dispozitave ligjore të legjislacionit të punës e kryesisht për marrëdhëniet e punës dhe risk informaliteti në të gjitha format e shfaqjes së tij.
3. Inspektime për herë të parë duke zgjeruar hartën e inspektimeve.


Gjatë vitit 2024, mesatarja e inspektimeve që u realizuan mbi bazë planifikimi zë **75%** të inspektimeve totale të kryera. Në këtë shifër ka ndikuar përfshirja në aksionin antiinformalitet me çështje jashtë planifikimi e ku planifikimi i muajit dhjetor u realizua në masës 8%.

Përdorimi i platformës **MIRA (Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut)** ka sjellë një qasje të re në inspektimin e punës. Teknikat e avancuara të Inteligjencës Artificiale, si data mining dhe machine learning, kanë ndikuar drejtpësdrejt në planifikim të zgjuar dhe në dërgimin e inspektimit të punës në subjekte me risk potencial në mos zbatimin e dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Rezultatet e më poshtme, janë pjesë e inspektimeve të planifikuara mbi bazë risku:

- **52%** e punëmarrësve evidetuar të kryejnë punë të pasiguruar në skemën e sigurimeve shoqerore e shëndetësore (informalitet i zi) janë pjesë e inspektimeve të planifikuara.
- **57%** e punëmarrësve evidetuar të kryejnë punë pa lidhur kontrata pune me punëdhënësit e tyre, (informalitet gri), janë pjesë e inspektimeve të planifikuara.
- **74%** e punëmarrësve evidetuar që paguhen me pagë minimale për punën e kryer, janë pjesë e inspektimeve të planifikuara.

- **67%** e punëmarrësve evidentuar që nuk paguhen për orët e punuara mbi kohën normale të punës (informalitet gri), janë pjesë e inspektimeve të planifikuara.



Orientimi i planifikimit të inspektimit gjatë vitit 2024, prioriteti i planifikimit kanë qënë subjektet me risk potencial të mbartjes së informalitetit në të gjitha format e shfaqjes së tij (marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës, duke përfshirë moszbatim të dispozitave ligjore në lidhje me kontratat e punës, pagesa për punë të kryer në ditët e festave zyrtare, orëve përtej kohëzgjatjes normale të punës, mos pagesës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore etj). Në planifikimin vjetor të inspektimeve, risku potencial për informalitetit në të gjitha format e shfaqjes së tij është projektuar në 48% e subjekteve.



MIRA (Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut), bazuar në teknika të avancuara të Inteligjencës Artificiale, si data mining dhe machine learning, për të mbledhur, analizuar dhe përdorur të dhënat në kohë reale:

1. Orienton inspektorët që të marrin vendime objektive, të unifikuar sipas standardeve ligjore të mirëpërcaktuara.
2. Orienton planifikimin e inspektimeve në subjekte me rrezik potencial të lartë në moszbatimin e ligjit.
3. Ndërgjegjësojë punëdhënës, për zbatimin e dispozitave ligjorë të Legjislacionit të Punës.

MIRA nuk është vetëm një sistem teknologjik, por një standard i ri që kombinon teknologjinë dhe transparencën për një treg pune më të drejtë dhe të qëndrueshëm. Transparenca në procesin e inspektimit ka rritur besueshmërinë dhe efektivitetin e inspektimeve, duke zhvendosur fokusin nga inspektorët tek vetë procesi. Ky ndryshim ka sjellë vendimmarrje më të informuara, ndërgjegjësim më të lartë për zbatimin e standardeve të punës dhe ka forcuar integritetin dhe cilësinë e inspektimeve. MIRA modernizon planifikimin duke përdorur koeficientë risku për çdo subjekt dhe orienton planet e inspektimit nga Drejtoria Qendrore drejt rajoneve, duke zëvendësuar



proceset manuale me automatizim në kohë reale. Rezultatet janë inkurajuese: 63% e rasteve të punësimit informal të evidentuara janë pjesë e planifikimeve, duke përmirësuar ndjeshëm efektivitetin dhe përshpejtuar procesin, ndërsa inspektorët fokusohen në shkeljet më kritike.

Sektori i Mbikqyrjes së Marrëdhënieve të Punës

Sektori i Mbikqyrjes së Marrëdhënieve të Punës ka një rol thelbësor në monitorimin, administrimin dhe mbikqyrjen e ankesave të depozituara pranë ISHPSHSH, si dhe në trajtimin e çështjeve që lidhen me marrëdhëniet e punësimit, përfshirë kategoritë e veçanta si të miturit dhe gratë shtatzëna që mbrohen me legjislacion të posaçëm. Ky sektor siguron që të gjitha ankesat dhe çështjet e punës të trajtohen drejtësisht dhe në përputhje me ligjin, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të punonjësve dhe zbatimin efektiv të legjislacionit të punës.

Administrimi i Ankesave

Sektori administron në formë elektronike “Rregjistrin e Ankesave”, në të cilin rregjistrohen të gjithë ankesat/denoncimet/kërkesat që depozitohen pranë institucionit në nivel qendror dhe rajonal. Gjatë vitin 2024 janë depozituar në total **920** ankesa/kërkesa prej të cilave:

- **90.5 %** janë depozituar drejtpërdrejtë pranë ISHPSH në kanalet e komunikimit të ndërtuara për këtë qëllim dhe **9.5 %** janë përcjellë nga Platforma e Bashkëqeverisjes.
- **80 %** janë ankesa/denoncime nga punëmarrës dhe **20 %** janë kërkesa për informim dhe sqarime ligjore, tregues i transparencës institucionle dhe besimit në informacion.

Trajtimi i ankesave është kryer kryesisht përmes proceseve të mirëfillta të inspektimit, ndërkohë që pjesa tjetër është trajtuar me përgjigje bazuar në të dhëna të disponuara ne institucion. 100% e kërkesave për sqarime ligjore kanë marrë përgjigje, në përmbushje të misionit të Inspektoratit Shtetëror të Punës *“t’u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efikase të shqyrtimit të dispozitave ligjore* », duke ndikuar në këtë mënyrë në qartësimin e situatave dhe indirekt në zbutjen e konflikteve potenciale.

Numrin më të madh të denoncimeve të trajtuara i përkasin Drejtorisë Rajonale Tiranë me 61.3 %, Rajoni Vlorë 8.3 %, Rajoni Korçë 4.3 %, Rajoni Shkodër 2.3 %, Rajoni Gjirokastrë 2.7%, Rajoni Dibër 1% dhe ankesa/kërkesa për informim dhe sqarime ligjore të trajtuara nga Drejtoria Qendrore 20.1%. Ankesat e adresuara sipas llojit të ankimit janë të pasqyruara si më poshtë:

Sipas Arsyesh së Ankesës	Nr. Ankesa	Zgjidhja në %
Cënim të marrëdhënieve të punës	122	71.3%
Mospagesë e pagave të prapambetura	191	76.4%
Mospagesë të kontributit të sigurimeve shoqërore	101	78.2%
Punësimi të paligjshëm	13	69.2%
Ndërprerje të marrëdhënieve të punës	142	64.8%
Mosnjohim aksidenti në punë	9	66.6%
Kushte të pasigurta pune	17	47 %
Mos pagesë të raporteve mjekësore	28	75 %
Trajtim jo të barabartë në vendin e punës dhe diskriminim	7	42.9%
Zbatimi i kontratave kolektive, Pushimeve kolektive	16	87.5 %
Të tjera	256	91 %

Mos lidhje kontrate e mosrespektim i oreve te punes	17	64.7%
Punësim i paligjshëm të të miturve	1	100%
Kërkesa për sqarime / informime ligjore	185	100%
Totale	920	77%

Numri më i madh i denoncimeve të adresuara dhe të trajtuara nga ISHPSHSH janë ankesat për shkelje të të drejtave dhe mospërbushje të detyrimeve të punëdhënësve kundrejt punëmarrësve. Këto ankesa përfshijnë mospagesën për punë të kryer në ditët e festave zyrtare, ditë të pushimit javor, punë të kryer në orë shtesë, moslidhje kontrate pune, dhe çështje të ngjashme. Institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përbushur standardet e punës, veçanërisht në zbatimin e kuadrit ligjor rregullues.

Në përgjigje të pretendimeve të ngritura në ankesa dhe gjatë vizitave inspektuese, ISHPSHSH i ka kushtuar vëmendje të veçantë informimit dhe këshillimit të punëmarrësve mbi rëndësinë e lidhjes së kontratës individuale të punës, në përputhje me Kodin e Punës së RSH. Kontrata individuale është dokumenti kryesor ku dakordësohen të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe siguron transparencë për pagën dhe elementët e saj përbërës. Informimi i punëmarrësve për këtë detyrim ligjor që në fillim të marrëdhënies së punës është thelbësor për të garantuar shpërblimin e drejtë dhe deklarimin e saktë të punës së kryer.



Një vëmendje e veçantë gjatë vitit 2024 i është kushtuar respektimit të të drejtave të punëmarrësve të huaj, me një rritje të ndjeshme të numrit të tyre. Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024–2030, ISHPSHSH ka kryer inspektime në Agjencitë Private të Punësimit (sipas Urdhrit të Ministrit nr.351, datë 29.05.2024), duke identifikuar problematika dhe dhënë rekomandime që ndikuan në ndryshimet ligjore për licencimin dhe monitorimin e këtyre subjekteve. Ndryshimet ligjore përfshijnë: forcimin e kriterëve të licencimit përmes ndryshime të ndodhura në VKM nr.538/2009; përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të agjencive përmes VKM nr.703/2024; dhe miratimin e Udhëzimit nr.757/2024 për procedurat e licencimit dhe monitorimit të subjekteve ndërmjetësuese, me ISHPSHSH të ngarkuar për inspektimin dhe vlerësimin e tyre.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me Organizatën Shqiptare e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ASDO), në partneritet me GIZ, përmes projektit "Fuqizimi i punëtorëve migrantë përmes një Kuadri 3-R", janë organizuar takime, tryeza të rumbullakta mbi çështjet e puntorëve



migrantë, të cilat kanë shërbyer për të evidentuar problematikat kryesore përfshirë çështjet ligjore, kushtet e punës, si dhe të të drejtave dhe mirëqënies së puntorëve migrant. Po në këtë kuadër janë publikuar në rrjetet sociale të institucionit materiale informuese që kanë pasur si qëllim ndërgjegjësimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve për migracion të rregullt në Shqipëri.

ISHPSHSH ka trajtuar me seriozitet denoncimet për shkelje të të drejtave të punëmarrësve të huaj, megjithëse ato përbënin vetëm 0,44% të totalit të ankesave, duke siguruar mbrojtje dhe trajtim të barabartë për ta. Gjithashtu, 0,54% e ankesave i përkisnin subjekteve të ndërmjetësimit në tregun e punës, duke evidentuar mungesën e informacionit të punëmarrësve mbi të drejtat e tyre në marrëdhëniet e punësimit të përkohshëm. ISHPSHSH ka ushtruar kompetencat e tij për zbatimin e Kodit të Punës, duke dhënë këshilla teknike punëdhënësve për masat parandaluese kundër dhunës, ngacmimit dhe shkeljeve të tjera, për të garantuar një mjedis pune të sigurt dhe të denjë. Një fokus i veçantë iu kushtua trajtimit të ankesave nga organizatat sindikale, për zbatimin e kontratave kolektive, procedurat e negociatave dhe ushtrimin e lirive sindikale.

Kategoritë e Veçanta të Punëmarrësve

Një fokus dhe vëmendje e veçantë në praktikën inspektuese mbetet edhe kontrolli i zbatimit nga ana e subjekteve të dispozitave ligjore të punës për kategoritë e veçanta të punëmarrësve, kryesisht “Punëmarrës nën 18 vjeç”, “Personat me aftësi ndryshe” dhe “Gratë shtatzëna” dhe “Nënat me fëmijë në gji”.

Gjatë vitit 2024, në kontrollet e ushtruara janë konstatuar 124 punëmarrës nën 18 vjeç, nga të cilët 75.8% i përkasin sektorit Tregti dhe HBR, 22.6% Ndërmarrje Prodhuese dhe 1.6% Ndërtim. Një vëmendje e veçantë nga trupa inspektuese i është kushtuar vlerësimit të punëdhënësit dhe ISHPSHSH-së për dhënien e Autorizimit Paraparak, duke garantuar kushte pune të përshtatshme dhe për të siguruar që kësaj kategorie punëmarrësish të mos u cënohet e drejta e arsimimit për shkak të punës që do të kryejnë. ISHPSHSH ka refuzuar raste që nuk plotësonin kushtet ligjore.

Denoncimet për mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave pas lindjes janë 1.53% e totalit, me fokus në mbrojtjen me të ardhura dhe sigurinë në punë. Zbatimi i ligjit ka siguruar respektimin e të drejtave për kohëzgjatjen e punës, mbrojtjen nga largimi për shkak të shtatzënisë dhe mbrojtjen

për largimin nga puna për shkak të shtatzënisë si dhe mbrojtjen me të ardhura të nënës të respektohen, në përmbushje të misionit që ligji ngarkon inspektorin e punës.

Me qëllim zbatimin e ligjshmërisë për ndalimin e punës së detyruar, mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e interesit të fëmijëve dhe punëmarrësve të huaj, ISHPSHSH ka vijuar gjatë vitit 2024 referimin e rasteve në strukturat përgjegjëse, duke zbatuar VKM nr.499/2018 për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe VKM nr.129/2019 për identifikimin dhe ndihmën për fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht. Rastet e punësimit të të miturve në kushte të ndaluara janë referuar pranë Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale. Gjithashtu, ISHPSHSH ka monitoruar dhe ndjekur kërkesat për punë jashtë orarit maksimal, duke siguruar që autorizimet për punë shtesë të jenë në përputhje me ligjin dhe të mos rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e punonjësve.

Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë realizon mbikqyrjen e procesit të inspektimit në punë në nivel rajonal mbi efektivitetin dhe cilësinë e procesit të inspektimit, në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për të gjitha subjektet që janë objekt i kontrollit nga ISHPSHSH si dhe siguron dhënien e asistencës teknike për inspektorët e punës dhe për përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve kur i kërkohet nga këta të fundit, për zbatimin e Ligjit të Sigurisë e Shëndetit në Punë.

Menaxhimi i Hetmit dhe Inspektimit të Aksidenteve në Punë

Aksidentet në punë kanë qenë dhe mbeten një prioritet për ISHPSHSH. Të dhënat statistikore të viteve të fundit tregojnë një nivel të qëndrueshëm të aksidenteve të regjistruara dhe hetuara. Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë administron “Regjistrin e Aksidenteve në Punë”, ku regjistrohen të gjitha aksidentet e raportuara, duke informuar strukturat e ISHPSHSH në nivel rajonal dhe qendror. Në vitin 2024, u regjistruan 233 raste aksidentesh në punë, për të cilat u hapën çështje inspektimi. Pas verifikimeve, 82.9% e tyre u klasifikuan si aksidente pune, ndërsa 17.1% nuk u vlerësuan si të tilla sipas parashikimeve ligjore.

Përveç detyrimit ligjor për njoftim dhe deklaram të aksidenteve nga punëdhënësit, gjatë vitit 2024 njoftimet për aksidentet në punë janë marrë edhe nga burime të tjera si media, prokuroria, policia e shtetit, punëmarrësit apo të afërmit e tyre. 90% e aksidenteve janë raportuar nga punëdhënësit, një rritje prej 2.4% krahasuar me vitin e kaluar, duke treguar ndërgjegjësim më të lartë për deklaramin e ngjarjeve. Një rritje prej 1.5% është vërejtur edhe në njoftimet nga punëmarrësit ose familjarët e tyre, duke reflektuar një besueshmëri më të madhe ndaj ISHPSHSH-së për trajtimin e rasteve të aksidenteve në punë.

“Regjistri i Aksidenteve në Punë” i administruar nga Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë përmban informacion mbi të gjitha aksidentet e ndodhura dhe të raportuara gjatë vitit kalendarik 2024. Sipas këtij regjistri, rezultojnë 195 punëmarrës të aksidentuar, nga të cilët 177 u klasifikuan si aksidente në punë deri më 31 Dhjetor 2024, nga të cilët 33 raste me pasojë vdekjen. Hetimet për pjesën e mbetur vijuan në janar 2025. Ndër aksidentet e raportuara, 10.7% ishin aksidente rrugore të lidhura me punën, përfshirë 3 raste me pasojë vdekjen. Gjithashtu, në vitin 2024 u regjistruan 3 incidente pune, një praktikë që ka kontribuar pozitivisht në përmirësimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Sektori i ndërtimit përbën 24% të aksidenteve në punë gjatë vitit 2024, duke mbetur një nga sektorët me risk më të lartë për aksidente, për shkak të zhvillimit të shpejtë dhe 1,019 kantierëve të pajisur me leje ndërtimi sipas INSTAT. Pavarësisht kontrolleve intensive nga ISHPSHSH, aksidentet në këtë sektor mbeten një sfidë, duke kërkuar forcimin e sistemeve të sigurisë, rritjen e rolit të Koordinatorit të Sigurisë dhe ndërgjegjësimin e punëdhënësve për zbatimin e kërkesave ligjore. Sektori minerar ka regjistruar 33 aksidente ose 15.2% të totalit, me 18.7% të aksidenteve fatale. Ky sektor konsiderohet me risk shumë të lartë, ku inspektimi në nëntokë kryhet nga AKSEM në bashkëpunim me ISHPSHSH.



Në vitin 2024, është vënë re një rritje e përqindjes së subjekteve që disponojnë “Dokument Vlerësim Risku”, kanë emëruar Koordinatorin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, krijuar Këshillat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe kanë angazhuar Mjekun e Ndërmarrjes. Pavarësisht kësaj rritjeje, ISHPSHSH ka vijuar punën për të rritur efektivitetin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke u fokusuar veçanërisht në detyrat e Koordinatorit të Sigurisë, funksionimin e Këshillave të Sigurisë dhe zbatimin praktik të masave të përfshira në Dokumentin e Vlerësimit të Riskut. Këto përpjekje synojnë krijimin e sistemeve funksionale të sigurisë dhe shëndetit për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Në kuadër të objektivit kryesor të ISHPSHSH-së për ndërgjegjësimin mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, janë përgatitur dhe shpërndarë 4000 fletë-palosje informuese në të gjithë Shqipërinë për Ditën Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, më 28 Prill 2024. Më 18 Qershor 2024, ISHPSHSH me mbështetjen e EU-OSHA organizoi seminarin “Rritja e ndërgjegjësimin të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në koherencë me strategjitë e BE-së”, me pjesëmarrjen e aktorëve kyç në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë si Agjencia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Sindikata Hungareze, koordinatoreja e ILO-s për Shqipërinë, përfaqësuesit nga Ministria Përgjegjëse për Punën, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si dhe përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve, punëmarrësve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë. Seminari promovoi një kulturë pune të sigurt dhe të shëndetshme, duke theksuar reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Pjesëmarrësit nga shkëmbyen përvojat e tyre dhe strategjitë për të përforcuar sigurinë dhe shëndetin në punë në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare.



Gjatë muajit Tetor, në kuadër të Fushatës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023-2025, me sloganin “Vende Pune të Shëndetshme, në Epokën Dixhitale”, ISHPSHSH ka zhvilluar aktivitete për ndërgjegjësimin mbi ndikimin e teknologjive dixhitale në vendin e punës dhe menaxhimin e tyre në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare si shpërndarja e materialeve informuese në të gjitha Drejtoritë Rajonale, trajnime mbi menaxhimin e rrezeve nga teknologjitë dixhitale, dhe vizita këshilluese në 36 subjekte ndërtimi me 1050 punëmarrës dhe 45 subjekte të tjera me 2987 punëmarrës. Janë organizuar takime ndërgjegjësuese në 18 shkolla profesionale me 1716 nxënës, duke informuar për sigurinë në punë, rolin e ISHPSHSH dhe sfidat e teknologjisë si stresi, izolimi social dhe humbja e aftësive, me fokus në krijimin e vendeve të punës të denja dhe të sigurta.



Sektori i Statistikës

Sektori i Statistikës harton, përpunon dhe analizon të dhëna statistikore, që dalin nga procesi i inspektimit, sipas detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e ILO-s nr 81 “Për inspektimin e punës në Industri e Tregti”. Burimi kryesor i të dhënave të inspektimit bazohet në procesin e inspektimit të punës nga niveli Qëndror dhe Rajonal.

Analiza e treguesve statistikorë të inspektimit

Gjatë vitit 2024 janë inspektuar **9,860** subjekte ekonomike private e shtetërore, ku punonjës të punësuar në këto subjekte janë **190,340** të cilët janë vende pune të kontrolluara, me një mesatare 19.3 punëmarrës/subjekt dhe mestararisht 128 inspektimeve për inspektor. Më poshtë paraqitet një tabelë me inspektimet krahasimtare të vitit 2023 dhe vitit 2024, si dhe mesatares së vendeve të punës për subjekte.

Viti	Subjekte Private dhe Shtetërore			Subjekte Private		
	Inspektime Nr.	Nr. PM	Mesatare PM/Sub	Inspektime Nr.	Nr. PM	Mesatare PM/Sub
2023	9,938	216,594	21.7	9,820	201,678	20.5
2024	9,860	190,340	19.3	9,746	171,201	17.6

Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, treguesit dhe indikatorët kryesor të inspektimit shënojnë rritje, në raport me konstatimin e punësimit informal dhe numrit të inspektimeve me masa administrative të cilat flasin për rritje të vetë cilësisë së inspektimit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, në lidhje me numrin e inspektimeve rezultojnë 1% inspektime më pak, por edhe këtë vit kemi pasur vakanca në numër inspektorësh, por që kjo nuk ka ndikuar tek treguesit cilësor të inspektimit.

Tabela: Treguesit kryesor të inspektimit të punës për vitin 2024, me bazë krahasimi vitin 2023 disagreguar në aspektin gjinor

Tregues Inspektimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	9,860 ¹	9,938	10154
Vende pune të inspektuara	190,340	216,594	227,343
Punëmarrëse femra Private + Shtetërore	90521	106,368	118,539
Mesatare e punëmarrësve për subjekt	19.3	21.79	22,3
Subjekte private të inspektuara	9,746	9,820	10,063
Vende pune të inspektuara në Subjektet Private	171,201	201,678	212,816
Punëmarrëse femra në Subjekte Private	84,957	92,276	113,501
Mesatare punëmar/subjekt në Subjekte Private	17.6	20.5	21,1
Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	3,952	2,502	2,946
Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	1,758	1047	1,202
Punëmarrës informal të evidentuar	2,600	1,965	1799
Punëmarrëse informale femra të evidentuar	1008	741	647
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	2,575	1,949	1,785
Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	996	741	643
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	124	215	171
Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	51	75	55
Punëmarrës të huaj të evidentuar	1536	1,350	722
Punëmarrës të huaj, pa leje pune	93	27	21
Punëmarrës me aftësi të kufizuar	46	103	111
Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	11	25	35
Punëmarrës që kryejnë punën në shtëpi (telepuna)	2,730	190	1185
Punëmarrëse femra që kryejnë punën në shtëpi (telepuna)	1,790	119	689
Subjekte me masë “Pezullim” për marrëdhëniet e punës	1,098	936	940
Subjekte me masë “Pezullim” për sigurinë e shëndetit	318	179	98
Subjekte me masë “Paralajmërim”	1,807	1,243	1226
Subjekte me masë Gjobë”	210	148	135
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	53,770,000	43,735,000	28,340,000
Inspektime të programuara	7,374	8,254	7,737
Inspektime me tematikë	1,448	848	1501
Inspektime për shkak ankese	690	544	520
Inspektim rastësor	124	74	188
Inspektime për shkak aksidenti në punë	224	218	208
Punëmarrës të aksidentuar në punë	177	168	184
Punëmarrëse femra të aksidentuara në punë	33	21	33
Punëmarrës të aksidentuar në punë me vdekje	33	30	32
Punëmarrëse femra të aksidentuara në punë me vdekje	2	1	1

¹ Përdorur Filtri- inspektime të mbyllura nga data 01.01.2024 deri me 31.12.2024.

Në analizën e inspektimeve/kontrolleve, sipas arsyes së inspektimit, rezultojnë se ISHPSHSH numrin më të madh të kontrolleve e ka mbi bazë planifikimi me 75 % të totalit të inspektimeve, tregues pozitiv, në kushtet kur ky programim kryhet mbi bazë risku.

Arsye e inspektimit	Nr. Inspektimeve	% kundrejt totalit
Të programuara	7,374 ²	75 %
Tematike, (riinspektim, kërkesë, këshillim, urdher ministri, Ipard, etj.)	1448	11.6%
Ankese	690	7%
Aksidenti në punë	224	2%
Rastësor	124	1%
Total	9,860	100%

Tabela: **Numri Inspektimeve të Programuara sipas Drejtorive Rajoneve**

Drejtoritë Rajonale	Inspektime Total	Inspektime të Programuara	% kundrejt totalit
Rajoni I - Tiranë	5,656	4,205	74%
Rajoni II - Vlorë	1,026	727	71%
Rajoni III - Dibër	309	209	68%
Rajoni IV - Korçë	1,191	1,037	87%
Rajoni V - Shkodër	736	574	78%
Rajoni VI - Gjirokastër	716	622	87%
Drejtoria Qendrore	226	-	0%
Total	9,860	7,374	75%

Në drejtoritë rajonale që paraqiten me nivel më të ulët përqindje të inspektimeve të programuara, kanë ndikuar kryerja e inspektime jashtë program, si aksident në punë, denoncim nga të tretët, rastësorë për shkak të shkeljeve flagrante etj, mbi bazë të specifikës, që paraqet rajoni - **25 % e totalit të inspektime janë inspektime jashtë programimi.**

Tabela: **Numri i inspektimeve “Jashtë Programimi”**

Drejtoritë Rajonale	Nr. Insp Gjithsej	Nr. Inspektimeve Jashtë Programi				% ndaj totalit
		Tematike	Aksident Punë	Ankesë	Rastësore	
Rajoni Tiranë	5656	791	100	524	36	
Rajoni Vlorë	1026	185	32	70	12	
Rajoni Dibër	309	40	37	7	16	
Rajoni Korçë	1191	85	18	33	18	
Rajoni Shkodër	736	117	15	20	10	
Rajoni Gjirokastër	716	43	5	24	22	
Drejtoria Qendrore	226	187	17	12	10	
Totali	9,860	1448	224	690	124	

Nga analiza e inspektimeve mbi bazë të llojit të aktivitetit ekonomik të subjekteve, inspektuar gjatë vitit 2024, rezulton se krahasimisht me një vit më parë, shënojnë ritje:

² Përdorur filtri në e-inspektimi subjekte mbyllur, jashtë plani-Jo, Mbyllur nga data 01.01.2024 deri me datë 31.12.2024.

- 42.6 % rritje në Sektorin e Ndërtimit, për shkak të angazhimit të trupës, bazuar në orientimin e inspektimeve në aktivitetet ndërtuese si dhe fushatës ndërgjegjësuese.
- 9 % rritje Aktivitete “Të tjera”. Në këtë zë, ka ndikuar kontrolli i subjeteve shtetërore, në zbatim të objektivitetit institucional për rritjen e kontrollit në këtë kategori subjektsh si dhe inspektimet në Agjencitë Private të Punësimit bazuar në urdhrat e dalë.

Kjo rritje është tregues i qartë i përputhjes së programimit/ orientimit të inspektimeve në raport me zbatimin e objektivave vjetore institucionale.

Tabela: Numri i Inspektimeve, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Lloji Aktivitetit	Nr. Inspektime 2024	Nr. Inspektime 2023
1. Bujqësi pyje peshkim	32	59
2. Miniera kariera	194	182
3. Ndërmarrje prodhuese	1,533	1,914
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	119	108
5. Tregti (H-B-R)	3,305	3,798
6. Ndërtim	2,547	1,786
7. Transport	153	235
8. Financë. Shërbime	54	62
9. Të tjera	1,923	1,794
TOTAL	9,860	9,938

Tabela: Numri i Inspektimeve sipas Llojit të Aktivitetit (ILO), në Nivel Rajoni.


Drejtoria Rajonale	Lloji i Aktivitetit (ILO)									
	1. Bujqësi, Pyje Peshkim	2. Miniera kariera	3. Ndërmarrje Prodhuese	4. Elektricitet, Gaz, Ujë	5. Tregti (H-B-R)	6. Ndërtim	7. Transport Telekomunikacion	8. Financë, Shërbime	9. Të tjera	TOTAL
Rajoni Tiranë	0	5	701	28	1669	1740	68	11	1427	5656
Rajoni Vlorë	6	47	264	14	346	224	26	3	96	1026
Rajoni Dibër	1	103	11	35	51	69	10	3	26	309
Rajoni Korçë	14	12	313	28	479	200	12	4	129	1191
Rajoni Shkodër	1	11	111	11	357	138	28	31	48	736
Rajoni Gjirokastrë	3	13	120	2	390	153	8	1	26	716
Drejtoria Qëndrore	0	3	13	1	13	23	1	1	171	226
TOTAL	25	194	1533	119	3305	2547	153	54	1923	9860

Më poshtë do gjeni analizë të detajuar për inspektimet e kryera jashtë programimi me arsye inspektimi ankesë, aksident në punë, kërkesë subjekti, treguesit e inspektimeve të cilave shërbëjnë si indikatorë të qartë të problematikave që ka shoqëruar tregun e punësimit gjatë vitit 2024, krahasimisht me më parë.

Treguesit e Inspektimeve që janë kryer mbi bazë “Ankese”

Gjatë vitit 2024, më çështje inspektimi me arsye « Denoncim nga të tretët » ose « Ankesë », rezultojnë gjithsej 690 inspektime. Krahasimisht me një vit më parë kemi *27 % më shumë çështje inspektimi*. Ky është tregues i rritjes së kulturës së ndërgjegjësimit, për të drejtat dhe detyrimet ligjore nga punëmarrësit dhe punëdhënësit, si dhe rritje të besimit ndaj institucionit.

Grafik: Inspektimet për shkak “Ankese” sipas rajoneve për vitin 2023 dhe 2024



Numrin më i lartë subjekteve, që janë inspektuar në kuadër të ankesave të ardhura i takojnë Rajonit I – Drejtorisë Rajonale Tiranë me 76% të totalit. Gjatë 2024, ky rajon rezulton në këtë tregues me rritje me 115 inspektime më shumë se në vitin 2023, tregues që lidhet me faktin e përqendrimit të lartë të bizneseve që zhvillojnë aktivitetin ekonomik në këtë rajon dhe për një ndërgjegjësim më të lartë të punonjësve të punësuar në këto subjekte për të adresuar shqetësimet e tyre për zgjidhje. Gjithashtu tregues më i lartë krahasimisht me një vit më parë është dhe numri i inspektimeve të kryera nga inspektorë të Drejtorisë Qendrore, i cili tregon vëmendjen e madhe që i është kushtuar trajtimit të ankesave për raste apo situata komplekse.

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Ankese”, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO), në nivel rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Lloji i Aktivitetit (ILO)									
	1. Bujqësi, Pyje Peshkim	2. Miniera kariera	3. Ndërmarrje Prodhuese	4. Elektricitet, Gaz, Ujë	5. Tregti (H-B-R)	6. Ndërtim	7. Transport	8. Financë, Shërbime	9. Të tjera	TOTAL
Rajoni Tiranë	0	0	103	1	115	32	27	3	243	524
Rajoni Vlorë	1	0	25	3	15	2	2	1	21	70
Rajoni Dibër	0	1	0	2	0	0	0	0	4	7
Rajoni Korçë	0	0	15	1	6	3	0	0	8	33
Rajoni Shkodër	0	1	8	2	2	1	2	1	3	20
Rajoni Gjirokastrë	1	0	2	1	11	0	3	0	6	12
Drejtoria Qendrore	0	1	2	0	2	1	1	0	5	12
TOTAL	2	3	155	10	151	39	35	5	290	690

Në bazë të llojit të aktivitetit ekonomik të subjekteve, inspektuar për shkak ankese gjatë vitit 2023, rezulton se sektorët, punëmarrësit e të cilëve adresojnë më shumë ankese janë;

- 42 % i takojnë Aktivitete “Të tjera”, ku bëjnë pjesë Ndërrmarrjet Shtetërore, SHPSF (Shoqëritë e Ruajtjes së Sigurisë Fizike), Arsim, Agjencitë e punësimit etj.
- 22 % janë në Sektorin e Tregtisë (H-B-R), i cili vijon të ketë problematika për respektimin e kontratave të punës për punëmarrësit.
- 23 % janë në Ndërrmarrje Prodhuese ku numri më i madh i përket sektorit fason, që gjatë këtij viti është shoqëruar me luhataje të tregut dhe rrjeshimisht ka dhënë ndikim dhe në raportet e punësimit me punëmarrësit/et.

Në lidhje me konstatimet e marrëdhënieve të punës me informalitet të zi dhe gri, në inspektimet për shkak ankese kanë rezultuar;

- 165 punëmarrës të pasiguruar nga 85 një vit më pare, për 91% është bërë i mundur formalizimi i marrëdhënies së punësimit gjatë procsit inspektues. Diferenca është deleguar për kompetencë pranë Organeve të Tatim Taksave, për arsye të ankimit në periudhë më të vonë së përfundimi i marrëdhënies së punësimit të ankuesve, në atë punëdhënës.
- 393 punëmarrës nuk kishin një kontratë pune të rregullt, ku krahasimisht me një vit më parë shënon rritje në masën 75 % kjo kryesisht rrjedhje e ndërjegjësimit për kontrat e punës.
- 4,545 punëmarrës ose 9 % e totalit të punëmarrësve në ankesë, siguroheshin me pagë minimale, tregues i përmirësuar krahasuar me një vit më parë me 17 % më pak, duke patur parasysh që numri më i madh i punëmarrësve i takon aktivitetit “Ndërrmarrje Prodhuese” që janë Sektori Fason si dhe aktivitetit të “Tjera”.

Tabela: Informaliteti në inspektimet për shkak “Ankese”, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Lloji i Aktivitetit	Inspektime për ankese	Punëmarrës					
		Gjithsej	Femra	Pa kontrata	Informal	Formalizuar	Siguruar me pagë minimale
1. Bujqësi, Pyje, Peshkim	2	28	14	1	1	1	-
2. Miniera kariera	3	577	48	-	-	-	2
3. Ndërrmarrje prodhuese	155	18,100	12,977	209	24	24	1,518
4. Elektricitet, Gaz, Ujë	10	1,975	342	-	-	-	351
5. Tregti (H-B-R)	151	3,286	1,818	80	58	55	420
6. Ndërtim	39	514	73	16	18	18	115
7. Transport, Telekomunikacion	35	6,111	3,713	3	2	1	132
8. Financë, Shërbime	5	574	362	-	-	-	-
9. Të tjera	290	22,277	9,710	84	62	51	2,007
TOTAL	690	53,442	29,057	393	165	150	4,545

Analiza e të dhënave të informalitetit në marrëdhëniet e punësimit të punëmarrësve në inspektimet për shkak “Ankese”, sipas llojit të aktivitetit ekonomik në raport me totalin e të punësuarve në këto subjekte rezulton në;

- Nga 18,100 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 24 punëmarrës informal në “Ndërmarrje Prodhuese”
- 3,286 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 58 punëmarrës informal në aktivitete “Tregëti (H-B-R)”
- 514 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 18 punëmarrës informal në aktivitetin “Ndërtim”
- 6,111 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 2 punëmarrës informal në aktivitetin “Transport, Telekomunikacion”
- 22,227 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 62 punëmarrës informal në aktivitete “Të tjera”

Masat Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”

61 % e subjekteve, që janë inspektuar mbi bazë ankese kanë marrë masa administrative, përkatësisht Masë urgjente “Pezullim”. “Paralajmërim”, “Gjobë”, të ndarë në përqindje:

- 15 % e subjekteve kanë marrë Masë Urgjente “Pezullim”, për shkelje flagrante, që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- 35 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Paralajmërim”.
- 12 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Gjobë”.

Krahasimisht me një vit më parë, kemi 53 % më shumë subjekte në të cilat janë aplikuar masa administrative ligjore të dënimit, përkundrejt numrit të inspektimeve për ankesë, tregues që flet për angazhim serioz të strukturës inspektuese për subjektet, që nuk zbatojnë ligjin.

Tabela: Masa Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”, sipas Lloj Aktivitetit


Lloji i Aktivitetit (ILO)	Nr. Inspektime për shkak ankese	Masa administrative			
		Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (.000) Lekë
1. Bujqësi pyje peshkim	2	1	2	-	-
2. Miniera kariera	3	0	2	1	120
3. Ndërmarrje prodhuese	155	18	72	33	6,220
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	10	0	6	1	600
5. Tregëti (H-B-R)	151	40	51	4	330
6. Ndërtim	39	14	17	7	780
7. Transport, Telekomunikacion	35	2	9	5	1,280
8. Financë. Shërbime	5	0	1	1	100
9. Të tjera	290	27	79	28	6,140
TOTAL	690	102	239	80	15,570

Tabela: Masa Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”, mbi bazë Rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Inspektime për shkak Ankese	Masa Administrative			
		Pezullime	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (000) Lekë
Rajoni I - Tiranë	524	79	149	45	7,300
Rajoni II - Vlorë	70	5	49	12	3,190
Rajoni III - Dibër	7	0	5	0	0
Rajoni IV - Korçë	33	6	13	11	1,620
Rajoni V - Shkodër	20	3	4	6	1,860
Rajoni VI - Gjirokastrë	24	6	11	0	0
Drejtoria Qëndrore	12	3	8	6	1,600
Totali	690	102	239	80	15,570

Treguesit e Inspektimeve që janë kryer mbi bazë “Aksidenti në punë”

Gjatë vitit 2024 rezultojnë të aksidentuar në punë 177 punëmarrës, nga të cilët 33 me pasojë humbjen e jetës. Numri i inspektimeve me arsye “Aksidenti në punë”, rezultojnë gjithsej 224. Të dhënat e inspektimit për aksident, që paraqiten në grafikun e mëposhtëm, për 3 vitet e fundit, tregojnë një trend në ulje të numrit të punëmarrësve të aksidentuar në punë, ndërkohë që numri i subjekteve që janë inspektuar për këtë shkak është në trend rritës. Këtu ka ndikuar rritja e cilësisë së hetimit të rasteve të aksidenteve në punë, përmes një analize më të thelluar të fakteve për të gjithë subjektet e përfshirë në ngjarje.



Rajoni me numrin më të lartë të inspektimeve për “Aksident në punë” rezultojnë Rajoni I-Drejtoria Rajonale Tiranë, me shtrirje juridiksioni në qarqet Tiranë dhe Durrës me 100 subjekte të inspektuara për aksident në punë për këtë vit.

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Aksidenti në Punë” dhe Numrit i Punëmarrësve të Aksidentuar dhe me Vdekje, mbi bazë Rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Nr. Inspektimeve për Aksident në Punë	Punëmarrës	
		Të aksidentuar gjithsej	Të aksidentuar me vdekje
Rajoni I - Tiranë	100	80	14
Rajoni II - Vlorë	32	24	6
Rajoni III - Dibër	37	32	4
Rajoni IV - Korçë	18	18	4
Rajoni V - Shkodër	15	11	3
Rajoni VI - Gjirokastrë	5	3	1
Drejtoria Qendrore	17	9	1
TOTAL	224	177	33

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Aksidenti në Punë” dhe Numrit i Punëmarrësve të Aksidentuar dhe me Vdekje, mbi “Lloji të Aktivitetit” ekonomik.

Lloji i Aktivitetit (ILO)	Nr. Inspektimeve për Aksident në Punë	Punëmarrës	
		Të aksidentuar	Të aksidentuar me vdekje
1. Bujqësi pyje peshkim	-	0	0
2. Miniera kariera	34	29	5
3. Ndërmarrje prodhuese	35	25	3
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	11	8	1
5. Tregti (H-B-R)	25	21	3
6. Ndërtim	47	37	11
7.Transport, Telekomunikacion	3	3	1
8. Financë. Shërbime	3	1	0
9. Të tjera	66	53	9
TOTAL	224	177	33

Në këto inspektime si shkaqe të ndodhjes së aksidenteve në punë, lidhen kryesisht me moszbatim të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Shkaqet konkrete sipas “Llojit të Aktivitetit” në pjesën më të madhe të rasteve të aksidenteve të hetuara gjatë 2024, në:

- “Ndërtim” shkak i aksidentit lidhet kryesisht me rënien nga lartësia
- “Ndërmarrje prodhuese” shkak i aksidentit lidhet me përdorimin e makinerive
- Tregti (H-B-R) dhe “Të tjera” kanë patur shkak atë të aksidentit rrugor, që konsiderohet si aksident në punë për shkak të ligjit.

Vendimarrja e inspektorëve të punës, në këto inspektime ka qënë e drejtpërdrejtë për përmirësim të situatës, përmes detyrave të lëna dhe masave administrative sic parashikon ligji.

Masat administrative në inspektimet për shkak “Aksidenti në punë”

Në **100%** të subjekteve që janë inspektuar në kuadër të aksidentit në punë janë marrë masa administrative, në disa raste dhe dy masa për subjekt, përkatësisht; Masë urgjente “Pezullim”, “Paralajmërim”, “Gjobë”. Sipas përqindjes në raport me totalin i kemi;

- 22 % e subjekteve kanë marrë Masë Urgjente “Pezullim”, për shkelje flagrante që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- 65 % e subjekteve kanë marrës dënim kryesor “Paralajmërim”.
- 31 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Gjobë”.

Tabela: Masat administrative për “Aksident në punë”, mbi bazë Rajoni.

Drejtoria Rajonale/Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektime për Aksident në Punë	Masa Administrative			
		Pezullim	Paralaj mërim	Gjobë	Vlerë (000)
Rajoni I - Tiranë	100	32	58	34	9,380
Sek.Insp Tiranë	73	21	32	28	8200
Sek.Insp Durrës	27	11	26	6	1180
Rajoni II - Vlorë	32	7	24	8	2,800
Sek.Insp Berat	6	3	5	2	600
Sek.Insp Fier	13	2	8	2	800
Sek.Insp Vlorë	13	2	11	4	1400
Rajoni III - Dibër	37	3	28	10	4,400
Sek.Insp Dibër	37	3	28	10	4400
Sek.Insp Kukës	0	0	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	18	3	13	3	920
Sek.Insp Korçë	9	2	5	0	0
Sek.Insp Elbasan	9	1	8	3	920
Rajoni V - Shkodër	15	1	8	7	3,400
Sek.Insp Shkodër	6	1	5	3	1300
Sek.Insp Lezhë	9	0	3	4	2100
Rajoni VI - Gjirokastrë	5	1	3	2	400
Sek.Insp Gjirokastrë	3	0	1	0	0
Sek.Insp Sarandë	2	1	2	2	400
Drejtoria Qëndrore	17	3	12	5	3,200
TOTALI	224	50	146	69	24,500

Treguesit e Inspektimeve që janë kryer mbi bazë “Kërkese” të subjektit

Pjesë jashtë programimi inspektimi janë dhe inspektimet e kryera mbi bazë “Kërkese” me njoftim paraprak për subjektet. Duke qënë se këto kërkesa adresohen drejtpërdrejt përmes sistemit “e-albania” nga subjektet, shërbime këto të zhvilluara në kuadër të “Reformës së Deregulimit”, e që rezultojnë për vitin 2024 të jenë realizuar 74 gjithsej, përkatësisht;

- 39 % për marrje “Autorizimi për punëmarrës nën 18 vjeç”
- 18 % për marrje “Autorizimi për të kryer punë në orë shtesë”
- 43 % për marrje “Leje pune para fillimit të punës në ndërmarrje”

Tabela: Inspektimet mbi bazë kërkesë të subjekteve, mbi bazë rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Nr. Kërkesave / Nr. Inspektimeve		
	Autorizim punëmarrës nën 18 vjeç	Autorizim për punë në orë shtesë	Leje pune para fillimit të punës në Ndërmarrje Praktika të zakonshme
Rajoni I - Tiranë	19	9	10
Rajoni II - Vlorë	3	2	10
Rajoni III - Dibër	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	0	0	11
Rajoni V - Shkodër	2	2	1
Rajoni VI - Gjirokastër	5	0	0
Drejtoria Qëndrore	-	-	-
TOTALI	29	13	32

Sipas të dhënave më sipër, peshën më të madhe me 43 % e kanë inspektimet për paisje me leje pune për ushtrim aktiviteti para vënies në punë të ndërmarrjes. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, privatë ose publikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike fitimprurëse apo jofitimprurëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të pajisen me leje pune pranë ISHPSHSH-së para fillimit të aktivitetit, para hapjes së një kantjeri të ri, para zgjerimit të aktivitetit ekzistues si dhe para hapjes së vendeve të reja të punës.


Punësimi Informal

Bazuar në ligjin 9634/2006 “Për inspektimin e punës” (i ndryshuar), përkufizimi “Punësim informal” përcakton një marrëdhënie punësimi, që nuk i nënshtrohet nga ana ligjore dhe në praktikë kërkesave të legjislacionit të punës. Në këtë analizë kemi zgjedhur të analizojmë indikatorët kryesorë të informalitetit duke përfshirë dhe informalitetin (gri). Më poshtë referojmë indikatorin e punëmarrësit informal të evidentuar dhe raportuar nga Rajonet në inspektimet e programuara dhe në inspektimet e kryera jashtë programit. Fokusi kryesor i institucionit ka qenë dhe mbetet minimizimi i informalitetit në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës në çdo formë me të cilën shfaqet. Vlen të theksojmë në këtë krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë vihet re një rritje e numrit të punëmarrësve informal të konstatuar gjatë procesit të inspektimit me rreth **27 %**, tregues që lidhet me rritjen e performancës së inspektimit për të dërguar inspektimin në subjektet që mbartin më së shumti fenomenin.

Një përmirësim në kontrollin dhe marrjen e masave të informalitetit për inspektimin e punës ka dhënë dhe programimi mbi bazë risku, ku elementët e informalitetit, kanë ndikuar në përzgjedhje të subjekteve që kanë risk më të lartë si dhe bashkëpunimit të përmirësuar me institucionet dhe partnerët si DPT dhe QKB. Nga analiza e të dhënave statistikore në lidhje me elementët e informalitetit, konstatojmë se;

- 1347 punëmarrës ose 52 % e punëmarrësve informal të konstatuar janë punëmarrës të subjekteve që janë inspektuar mbi bazë programimi apo planifikimi inspektimi.
- 839 punëmarrës ose 26 % janë informal të konstatuar në inspektime tematike
- 414 punëmarrës ose 16 % e punëmarrësve informal të konstatuar janë punëmarrës të subjekteve që janë inspektuar jashtë programimi (inspektime, Ankesë, Aksident në Punë, Rastësor)

Grafik.Pnm Informal 2021-2024 sipas inspektimit, programuar, tematik, aksident, ankesë, rastësor.



Nga **2600** punëmarrës informal që janë evidentuar gjatë procesit të inspektimit, brenda procesit inspektues janë siguruar **2575** ose **99%** prej tyre. Rastet për të cilat nuk është bërë e mundur formalizimi gjatë procesit, janë deleguar për kompetencë rast pas rasti pranë Organeve të Tatim Taksave. Të dhënat për punësimin informal në nivel rajoni dhe sektori paraqitet si më poshtë:

Tabela: Informaliteti mbi bazë Rajoni/Sektor Inspektimi

Drejtoria Rajonale/ Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektimeve gjithsej	Punëmarrës		
		Gjithsej Punëmarrës	Informal	Formalizuar
Rajoni I - Tiranë	5656	126847	829	814
Sek.Insp Tiranë	4611	102173	660	653
Sek.Insp Durrës	1045	24674	169	161
Rajoni II - Vlorë	1026	21698	332	325
Sek.Insp Berat	199	2439	94	93
Sek.Insp Fier	315	9118	67	62
Sek.Insp Vlorë	512	10141	171	170
Rajoni III - Dibër	309	6371	135	135
Sek.Insp Dibër	309	6371	135	135
Sek.Insp Kukës	0	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	1191	13116	430	430
Sek.Insp Korçë	685	7227	278	278
Sek.Insp Elbasan	506	5889	152	152
Rajoni V - Shkodër	736	6680	573	570
Sek.Insp Shkodër	436	4291	252	251
Sek.Insp Lezhë	300	2389	321	319
Rajoni VI Gjirokastrë	716	6630	266	266
Sek.Insp Gjirokastrë	455	4181	108	108
Sek.Insp Sarandë	261	2449	158	158
Drejtoria Qëndrore	226	8,998	35	35
TOTALI	9,860	190,340	2,600	2,575

Tabela: Informaliteti në subjektet private, mbi bazë Lloji Aktiviteti.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës		
		Total Punëmarrës	Informal	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	31	310	5	1.6%
2. Miniera kariera	194	5,242	40	0.8%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,529	60,765	442	0.7%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	103	985	1	0.1%
5. Tregti (H-B-R)	3,305	36,144	1,258	3.5%
6. Ndërtim	2,544	19,948	650	3.3%
7.Transport, Telekomunikacion	151	8131	12	0.1%
8. Financë. Shërbime	54	1049	3	0.3%
9. Të tjera	1,835	38627	189	0.5%
TOTAL	9,746	17,1201	2,600	1.5%

Një indikator matës për eficensën e punës së inspektorëve është mesatarja e numrit të informalëve të konstatuar për inspektor. Kjo mesatare për vitin 2024 është **31³ Informal/Inspektor**. Krahasimisht me vitin 2023 reflekton përmirësim të punës, pasi ky indikator rezultonte në masën **25 Informal/Inspektor**. Në raport me indikatorin i përlogaritur si numri i punëmarrësve të padeklaruar (informal) për subjekt të inspektuar, për vitin 2024 rezulton **4 informal/subjekt**.

Sipas kategorive të punëmarrësve rezultojnë:

- 0.07 % e punëmarrësve të evidentuar, janë punëmarrës nën 18 vjeç.
- 0.02 % e punëmarrësve të evidentuar, janë punëmarrës me aftësi të kufizuar (PAK).

Sipas elementëve të punësimit që lidhen me kontratën e punës, rezultojnë:

- 2 % e punëmarrësve janë evidentuar të punojnë pa kontrata individuale pune, duke reflektuar një rritje prej 0.8% me një vit më parë.
- 18.2 % e punëmarrësve janë punëmarrës që sigurohen në bazë të pagës minimale duke reflektuar një ulje rreth 1.2 % me një vit më parë

Tabela: Kategoritë e Punëmarrësve me shpërndarje mbi bazë Rajoni.

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Punëmarrës						
	Gjithsej	Femra	Pa kontrata individuale	Siguar me pagë minimale	PAK	Nën 18 Vjeç	Të huaj
Rajoni I - Tiranë	12,6847	65,294	1149	17,218	8	39	837
Sek.Insp Tiranë	10,2173	51,429	923	11,703	3	3	390
Sek.Insp Durrës	24,674	13,865	226	5,515	5	36	447
Rajoni II - Vlorë	21,698	9,392	537	5,086	11	21	280
Sek.Insp Berat	2,439	894	230	1,001	0	5	45
Sek.Insp Fier	9,118	4,059	133	2,289	2	9	124

³ Llogaritur sipas numrit të inspektorëve që kanë tregues statistikorë si inspektor i parë për periudhën janar-dhjetor 2024 që janë 83.

Sek.Insp Vlorë	10,141	4,439	174	1,796	9	7	111
Rajoni III - Dibër	6,371	1,175	105	622	22	0	4
Sek.Insp Dibër	6,371	1,175	105	622	22	0	4
Sek.Insp Kukës	0	0	0	0	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	13,116	5,684	489	5,350	1	16	103
Sek.Insp Korçë	7,227	3,141	320	3577	0	2	19
Sek.Insp Elbasan	5,889	2,543	169	1,773	1	14	84
Rajoni V- Shkodër	6,680	2,817	557	1,269	1	5	104
Sek.Insp Shkodër	4,291	1,936	253	1,090	0	4	60
Sek.Insp Lezhë	2,389	881	304	179	1	1	44
Rajoni VI- Gjirokastrë	6,630	2,718	1072	2,719	0	43	98
Sek.Insp Gjirokastrë	4,181	1,756	338	1,500	0	10	49
Sek.Insp Sarandë	2,449	962	734	1,219	0	33	49
Drejtoria Qëndrore	8,998	3,441	43	2,448	3	0	110
Totali	190,340	90,521	3,952	34,712	46	124	1536

Punëmarrës pa Kontrata Individuale Pune

Një nga format e informalitetit në punësim është të punuarit pa një marrëveshje pune të shkruar. Gjithsej janë evidentuar 3,952 punëmarrës pa kontrata individuale pune në inspektimet e kryera ose rreth 2% e totalit të punëmarrësve. Krahasuar me një vit më parë kemi 1,450 ose **58 % më shumë punëmarrës pa kontrata pune**. Të dhënat për punëmarrës pa kontrata pune vetëm në subjekte private, sipas llojit të aktiviteteve ekonomike, përqindje më e madhe përkundrejt numrit të punëmarrësve në këto aktivitete evidentohet në llojin e aktivitetit: Tregti Hotel-Bar-Restorante me 5.6 %, Ndërtim me 3.5 %, Ndërmarrje Prodhuese 1.4%, kundrejt numrit të punëmarrësve evidentuar në këto aktivitete gjatë procesit të inspektimit.

Tab. Punëmarrës pa kontrata individuale pune sipas llojit të aktivitetit.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës		
		Në sektorin privat	Pa Kontrata Individuale	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	31	310	5	1.6%
2. Miniera kariera	194	5242	38	0.7%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,529	60,765	854	1.4%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	103	985	5	0.5%
5. Tregti (H-B-R)	3,305	36,144	2,029	5.6%
6. Ndërtim	2,544	19,948	703	3.5%
7. Transport, Telekomunikacion	151	8,131	15	0.2%
8. Financë, Shërbime	54	1,049	2	0.2%
9. Të tjera	1,835	38,627	293	0.8%
TOTALI	9,746	171,201	3,944	2.3%

Punëmarrës që sigurohen mbi pagën minimale.

Punësimi me pagë minimale rezulton në masën 19.5 % të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara gjatë vitit 2024. Krahasimisht me një vit më parë në sektorin privat kemi 18 % më pak punëmarrës me pagë minimale të konstatuar.

Tabela: Punëmarrës që sigurohen me Pagë Minimale sipas Llojit të Aktivitetit.

Lloji i Aktivitetit	Nr. Inspek Subjekte Private	Punëmarrës		
		Në sektorin privat	Siguruar mbi pagë minimale	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	31	310	146	47.1%
2. Miniera kariera	194	5242	401	7.6%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,529	60,765	10,533	17.3%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	103	985	144	14.6%
5. Tregti (H-B-R)	3,305	36,144	10,268	28.4%
6. Ndërtim	2,544	19,948	5,082	25.5%
7. Transport, Telekomunikacion	151	8,131	456	5.6%
8. Financë. Shërbime	54	1,049	53	5.1%
9. Të tjera	1,835	38,627	6,309	16.3%
TOTALI	9,746	171,201	33,392	19.5%

Punëmarrës të Huaj

Rritja e punësimit të punëmarrësve të huaj gjatë viteve të fundit ka sjellë një vëmendje të veçantë në praktikën inspektuese në kontrollin e kushteve të tyre të punës për të siguruar që ata të kenë kushte të sigurta, të drejta dhe të barabarta në punë. Gjatë vitit 2024 janë konstatuar 1536 punëmarrës të huaj ose 14 % më shumë se një vit më parë. Gjatë vitit 2024 me Urdhër Ministri nr.351, datë 29.05.2024, “Për kryerjen e inspektimeve në Agjencitë Private të Punësimit”, është ushtruar kontroll në 136 subjekte që ushtrojnë aktivitet Agjenci Private Punësimi, të cilat rezultojnë me marrëdhënieve të punës me punëmarrësit e huaj dhe jo vetëm.

Tabela: Punëmarrës “Të huaj”, të shpërndarë, sipas llojit të aktivitetit.


Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektive Subjekte Private	Punëmarrës	
		Të huaj	Pa leje pune
1. Bujqësi pyje peshkim	31	11	0
2. Miniera kariera	194	133	14
3. Ndërmarrje prodhuese	1,529	572	10
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	103	3	0
5. Tregti (H-B-R)	3,305	323	42
6. Ndërtim	2,544	128	8
7. Transport, Telekomunikacion	151	80	17
8. Financë. Shërbime	54	10	0
9. Të tjera	1,835	276	2
TOTALI	9,746	1,536	93

Masat Administrative⁴

Në vitin 2024, janë vendosur 3,433 masa administrative, që përfaqësojnë rreth 35% të subjekteve të inspektuara, si rrjedhojë e eviudentimit të shkelje të ndryshme të ligjit të punës, për të cilat është ndërhyrë me masat e nevojshme për t'u korrigjuar ato. Masa administrative janë vendosur për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, orëve të punës, pagave, etj. Në përqindje këto masa flasin për:

- 41 % janë “Pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe sigurisë në punë,
- 53 % janë “Paralajmërim”
- 6 % janë masa me “Gjobë”.

Në krahasim me vitet 2023 dhe 2022 treguesit kanë rritje dhe paraqiten si më poshtë,



Në lidhje me numrin e dënimeve administrative, për dënim kryesor "Palajmërim" dhe dënim kryesor "gjobë" në inspektimet që kanë rezultuar me shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat inspektorët e punës kanë aplikuar dënimet administrative, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rezultojnë **37 %** më shumë masa. Kjo tregon se inspektimet janë më efektive në zbulimin e shkeljeve të ligjit të punës dhe në vendosjen e masave administrative për t'u korrigjuar ato, duke rritur përgjegjësinë e subjekteve në respektimin e ligjit.

Tabela: Masa Administrative, në shpërndarje, sipas Rajoneve.

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektive	Masa Administrative				Në % kundrejt nr/inspektimeve
		Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Totale	
Rajoni I - Tiranë	5656	605	591	106	1302	23%
Sek.Insp Tiranë	4611	512	412	85	1009	22%
Sek.Insp Durrës	1045	93	179	21	293	28%
Rajoni II - Vlorë	1026	198	606	26	830	81%
Sek.Insp Berat	199	55	163	5	223	112%
Sek.Insp Fier	315	48	110	8	166	53%
Sek.Insp Vlorë	512	95	333	13	441	86%
Rajoni III - Dibër	309	92	177	12	281	91%
Sek.Insp Dibër	309	92	177	12	281	91%
Sek.Insp Kukës	0	0	0	0	0	0%
Rajoni IV - Korçë	1191	248	251	25	524	44%
Sek.Insp Korçë	685	141	163	12	316	46%

⁴ (Masë urgjente pezullim, paralajmërim, gjobë)

Sek.Insp Elbasan	506	107	88	13	208	41%
Rajoni V - Shkodër	736	93	27	22	142	19%
Sek.Insp Shkodër	436	39	15	10	64	15%
Sek.Insp Lezhë	300	54	12	12	78	26%
Rajoni VI- Gjirokastrë	716	158	89	2	249	35%
Sek.Insp Gjirokastrë	455	60	19	0	79	17%
Sek.Insp Sarandë	261	98	70	2	170	65%
Drejtoria Qëndrore	226	22	66	17	105	46%
TOTALI	9,860	1,416	1,807	210	3,433	35%

Rezulton që kundrejt numrit të inspektimeve,

- Rajoni III- Drejtoria Rajonale Dibër ka shkuar me masa administrative në 91 % të inspektimeve,
- Rajoni II- Drejtoria Rajonale Vlorë ka shkuar me masa administrative në 81 % të inspektimeve
- Rajoni IV- Drejtoria Rajonale Korçë ka shkuar me masa administrative në 44 % të inspektimeve.

Tabela: Masa Administrative, në shpërndarje, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Lloji i Aktivitetit	Masa Administrative	Në %
1. Bujqësi, Pyje, Peshkim	9	28%
2. Miniera kariera	143	74%
3. Ndërmarrje prodhuese	592	39%
4. Elektricitet, Gaz, Ujë	45	38%
5. Tregti (H-B-R)	1,160	35%
6. Ndërtim	1,022	40%
7. Transport	49	32%
8. Financë. Shërbime	13	24%
9. Të tjera	400	21%
TOTAL	3,433	35%

Tabela: Masa Administrative (Pezullim, Paralajmërim, Gjobë), në shpërndarje, sipas Llojit të inspektimit.

Lloji i Inspektimit	Nr. Inspektimeve	Totali i masave administrative	Në % kundrejt Inspektimeve
Inspektime të Programuara	7347	1943	26 %
Inspektime Tematike	1448	600	41 %
Inspektime për Aksident në Punë	224	265	118 %
Inspektime për shkak Ankese	690	421	61 %
Inspektime Rastësore	124	204	165 %

- Gjatë vitit 2024 janë vendosur **210 gjoba** për shkelje të dispozitave ligjore:
- 32 gjoba në inspektime të programuara
- 25 gjoba në inspektime tematike
- 69 gjoba për shkak aksidenti në punë
- 80 gjoba për shkak ankese (denoncime nga të tretët)
- 4 gjoba në inspektime rastësore.

Tabela: Masa Administrative “Gjobë”, sipas Rajoneve/Sektorëve të Inspektimit

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektive	Gjobë	Vlerë (000) Lekë
Rajoni I - Tiranë	5,656	106	22,580
Sek.Insp Tiranë	4611	85	18,540
Sek.Insp Durrës	1045	21	4,040
Rajoni II - Vlorë	1,026	26	6,990
Sek.Insp Berat	199	5	1,740
Sek.Insp Fier	315	8	3,000
Sek.Insp Vlorë	512	13	2,250
Rajoni III - Dibër	309	12	4,800
Sek.Insp Dibër	309	12	4,800
Sek.Insp Kukës	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	1,191	25	4,230
Sek.Insp Korçë	685	12	1,990
Sek.Insp Elbasan	506	13	2,240
Rajoni V - Shkodër	736	22	8,920
Sek.Insp Shkodër	436	10	4,060
Sek.Insp Lezhë	300	12	4,860
Rajoni VI - Gjirokastrë	716	2	400
Sek.Insp Gjirokastrë	455	0	0
Sek.Insp Sarandë	261	2	400
Drejtoria Qendrore	226	17	5,850
TOTALI	9,860	210	53,770

DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Organizon dhe menaxhon punën për zbatimin e detyrave që lidhen me përdorimin me efektivitet të burimeve ekonomike, njerëzore, kualifikimin trajnues, sipas legjislacionit në fuqi dhe strukturës organizative. Harton projektbuxhetin e ISHPSHSH-së dhe administron buxhetin e miratuar për strukturën e ISHPSHSH-së, në përmbushje të objektivave të institucionit. Puna e kësaj drejtorie menaxhohet nga tre sektorë: 1) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme; 2) Sektori i Çështjeve Ligjore; 3) Sektori i Financës.

Sektori I Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme

Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për rritjen e integritetit të institucionit dhe përmirësimin e kapaciteteve të tij nëpërmjet, rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve, zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, Kodit të Punës, komunikimit etik, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Një departament i mirë i burimeve njerëzore është një aset i paçmuar në krijimin e një mjedisi funksional të punës që ndihet i hapur dhe i pranueshëm për të gjithë duke promovuar bashkëpunimin, profesionalizmin dhe integritetin.

Strukturë Organizative

ISHPSHSH funksionon sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe struktura e miratuar me Urdhrin nr. 174, datë 10.09.2024 të Kryeministrit, ka ndryshuar numrin total të punonjësve

nga 165 në **163**, duke mbetur e organizuar në nivel qendror dhe rajonal. Në vitin 2024, 33 nëpunës u emëruan dhe 14 u larguan për arsye si dorëheqje, pension, pezullim statusi apo lëvizje paralele. Për 6 nëpunës, në pozicionet përgjegjës sektori, inspektorë pune, me statusin e nëpunësit civil është marrë masë disiplinore nga Komisionet Disiplinore të ngritura gjatë vitit 2024, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3, 6 mujore dhe 1 vjeçare”. Në fund të vitit 2024 rezultojnë 10 pozicione vakante të cilat janë shpallur nga DAP dhe janë në proces për tu plotësuar gjatë 2025.

Rritja e Kapaciteteve dhe Trajnimet

Gjatë vitit 2024, ISHPSHSH ka pasur objektiva të qarta për rritjen e kapaciteteve dhe performancës së personelit dhe trupës inspektuese. Ky vit është konsideruar i suksesshëm falë trajnimeve, takimeve dhe tryezave tematike që kanë ndihmuar në zhvillimin profesional të stafit, duke përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e inspektimeve. Trajnimet e organizuara gjatë gjithë vitit, brenda dhe jashtë institucionit, kanë siguruar njohuri mbi kuadrin ligjor, praktikat më të mira të inspektimit dhe përdorimin e zhvillimeve teknologjike, duke përgatitur trupën inspektuese për të përdorur këto mjete në funksion të një performace dhe cilësie më të lartë në inspektimin e punës. Disa nga aktivitetet apo trajnimet kryesore të zhvillura janë listuar më poshtë:

- ASPA - Trajnimet dhe sesione formuese mbi kuadrin ligjor edhe më gjërë në të cilin janë përfshirë gjatë gjithë vitit nëpunësit e ISHPSHSH-së.
- Trajnim mbi standardet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare të lidhura me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin e ndërveprimit e institucioneve inspektuese/monitories. Konventa 190 “Eliminimi i Dhunës dhe Ngacmimeve në Botën e Punës”, etj. – ILO (International Labor Organization)
- ASPA - Trajnim nga mbi temën “Hartimi i shkresave zyrtare” me pjesëmarrje nga nëpunë të drejtorisë qendrore, përgjegjës dhe kryeinspektorë rajonal.
- Trajnim i trajnerëve për inspektorë e punës organizuar nga AFD/Expertise France



- Trajnimi i detyrueshëm për pranim në shërbimin civil, hyrje në administratën publike, për të përfituar Statusin e Nëpunësit Civil. - DAP
- Trajnimi gjithë trupa inspektuese për njohjen dhe përdorimin e platformave të reja teknologjike Matrica e Penaliteteve dhe Sistemi i Analizës së Riskut.
- Trajnim nga ISHPSHSH-ja për inspektorët e rinj.
- Trajnim me temë Higjena Kibernetike, inteligjenca me burim të hapur dhe inxhinierinë sociale.
- Trajnim “Sigurimi i Mbrotjes së Punëtorëve në rastet e Vështirësive Financiare të Kompanisë.

- Trajnim “Mbrotja e të dhënave personale”
- Trajnim mbi Barazinë Gjinore në Aksesin në Mundësitë Ekonomike.
- Metodologjia e standarteve të shërbimeve shoqërore.
- Trajnim E-Learning course on labour inspection – ICT ILO
- Fuqizimi i punonjësve migrantë përmes ndërhyrjes 3R në Shqipëri - ASDO / GIZ
- Trajnim 2-ditor mbi etikën institucionale, udhëheqjen, kulturën organizative dhe analizë përmblylëse e punës për vitin 2024 ku është përfshirë i gjithë personeli i ISHPSHSH.



Këto trajnime dhe aktivitete kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve, duke i bërë ata më të përparuar dhe të aftë për të përballuar sfidat e inspektimit të punës në mënyrë efektive dhe profesionale.

Programi i Transparencës dhe Roli i Koordinatorit në ISHPSHSH

Programi i transparencës që funksionon sipas Ligjit nr. 119/2014, i ndryshuar, është një hap i rëndësishëm për sigurimin e të drejtës së informimit për qytetarët dhe të interesuarit në lidhje me informacionin e prodhuar dhe mbajtur nga ISHPSHSH-ja. Përmirësimi i qasjes dhe transparencës në informacionin publik është një praktikë e rëndësishme për të promovuar llogaridhënie dhe besueshmëri në institucionet publike. Mbajtja dhe përditësimi i koordinatorit për të drejtën e informimit në faqen zyrtare www.inspektoriatipunes.gov.al dhe në adresën e emailit info@sli.gov.al të përcaktuar nga ligji janë hapa të rëndësishëm për të siguruar që kërkesat për informacion të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjin. Gjate vitit 2024, pranë institucionit janë depozituar 32 kërkesa për informacion, të cila janë trajtuar brenda afateve kohore dhe në përputhshmëri të plotë me ligjin.

Sektori i Çështjeve Ligjore

Sektori i Çështjeve Ligjore ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore në lidhje me legjislacionin në fuqi për ISHPSHSH-në. Kjo përfshin asistencën juridike për çështje ligjore, mbikqyrjen dhe administrimin e procesit të masave administrative nga inspektorët e punës deri te fazat e ankimit administrativ, gjyqësor dhe monitorimit të ekzekutimit të dënimeve me gjobë. Sektori i Çështjeve Ligjore gjithashtu ka përgjegjësinë për përfaqësimin ligjor të ISHPSHSH-së në çështjet ku ajo është palë. Përveç kësaj, shqyrton aktet e ardhura për mendim dhe propozon ose adreson nevojat për ndryshime ligjore që lidhen me fushën e veprimtarisë së ISHPSHSH-së. Kjo përfshin hartimin e propozimeve ligjore dhe përfaqësimin e tyre në procesin e hartimit të ligjeve në fushën e punës.

Megjithëse ISHPSHSH është institucion me funksione ekzekutiv, ka mbajtur një rol aktiv në identifikimin e nevojave për ndryshime apo zhvillime të kornizës ligjore të inspektimit në punë, legjislacionit të punës dhe implementimit në praktiken inspektuese i çdo ndryshimi duke reflektuar zhvillime në manuale, procedura, rregullore, propozime për ndryshime ligjore etj. Kështu, ISHPSHSH nëpërmjet Sektorit Ligjor në bashkëpunim me sektorët teknikë ka qenë pjesë e grupeve ndërinstucionale të punës për projektaktet e mëposhtme që lidhem me:

1. Forcimin e rregullave të licencimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit përmes ndryshimeve të/në:
 - VKM-së nr.538, date 26.05.2009 "*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*", nëpërmjet së cilës u forcuan kriteret e licencimit të subjekteve që do të kryejnë ndërmjetësim në tregun e punës, ku tashmë agjencitë para licencimit i nënshtrohen inspektimit në vend, krahas dokumentacionit për përmbushje të kriterëve të përcaktuara.
 - VKM-së nr.101, datë 23.02.2018 "*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencive Private të Punësimit*", realizuar nëpërmjet VKM-së nr. 703, datë 13.11.2024. Ndryshimet lidhen kryesisht me normimin e parimeve të rekrutimit etik, vendosjen e disa kushteve që garantojnë seriozitet, stabilitet financiar dhe besueshmëri, si dhe mundësinë e monitorimit të këtyre agjencive gjatë gjithë aktivitetit të tyre mbi ruajtjen e kriterëve të licencimit.
 - Miratimin e udhëzimit të Ministrit përgjegjës për punës (aktualisht MEKI) nr. 757, datë 30.9.2024 për procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe monitorimin e tyre.
2. Pjesë e grupit ndërinstucional të punës në kuadër të procesit të derregullimit, për vlerësim të akteve ligjore që preken nga ky proces, me synim thjeshtimin e procesit për bizneset dhe qytetarët.
3. Kontribut direkt dhe propozime mbi:
 - *Disa ndryshime në ligjin 79/2021 "Për të huajt", fokusuar në kreun që rregullon punësimin e të huajve.*
 - *Projektligjin "Për vullnetarizmin".*
 - *Projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri".*
 - *Projektligji "Për përgjegjësinë financiare të punonjesve publike", të propozuar nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë.*
4. Në procesin e reformimit të inspektorateve, finalizuar me:
 - *Miratimin e ligjit Nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".*
 - *Ndryshimet në ligjin nr.9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e punës" i ndryshuar.*
 - *Ndryshimet në ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar.*
 - *Propozimet për ndryshimet në VKM-në e organizimit dhe funksionimit të ISHPSHSH-së.*
5. Pjesë e grupit të punës për hartimin e Rregullores së Këshillit Kombëtar të Punës.
6. Propozimet për ndryshime në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar duke adresuar mangësi të legjislacionit.

7. Propozime për vlerësim të akteve nënligjore të dala në bazë të nenit 97 të Kodit të Punës, mbi kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në favor të personave fizikë dhe juridikë, në sektorë të tillë të veprimtarisë si: Ndërmarrjet që furnizojnë me bukë dhe mjete që dëmtohen shpejt, H-B-R, Bujqësi, Kopshtari, Transporti automobilistik, Shtypin e shkruar dhe të folur, Shëndetësinë.

8. Shprehje qëndrimi dhe arsytet për shfuqizimin e katër Konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke qenë se konventat e mëposhtme kanë humbur qëllimin e tyre dhe nuk japim më një kontribut të dobishëm, konkretisht të:

- Puna e nëndheshme (Gratë) Konventa, 1935 (Nr. 45);
- Konventa për Dispozitat e Sigurisë (Ndërtesa), 1937 (Nr. 62);
- Konventa për Statistikat e Pagave dhe Orëve të Punës, 1938 (Nr. 63)
- Konventa e Inspektorateve (Territoret Jo-Metropolitane), 1947 (N. 85).

9. Dhënie kontribut për dokumentat strategjike si:

- Dokumenti Politik i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 2024-2030.
- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024–2026.
- Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025” të ndryshuar.
- Strategjia afatmesme të të ardhurave dhe plani i veprimit, 2024-2027.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025.

Dhënia e asistencës juridike për inspektorët dhe çështje specifike

Inspektorët e punës janë udhëzuar për zbatimin e saktë të dispozitave të legjislacionit të punës dhe ligjit procedural, me qëllim rritjen e cilësisë së inspektimit. Fushat kryesore të trajtuara kanë përfshirë njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të ri ose të ndryshuar, vënien në dispozicion të formateve të përditësuara, rregullat për njoftimin e akteve të inspektimit, dhe ndjekjen e procedurave për marrëveshjet e pagesave me këste të gjobave. Gjithashtu, është ofruar asistencë për kontrollin e zbatimit të trajtimit financiar suplementar për punonjësit e minierave në nëntokë, industrisë së naftës dhe gazit, si dhe të metalurgjisë. Pjesë e udhëzimeve ka qenë edhe detajimi i shkeljeve në procesverbalin e inspektimit dhe përmbushja e barrës së provës, duke siguruar një qasje të strukturuar dhe të plotë në procesin inspektues.

Ndjekia e vendimeve me masa administrative

Në vitin 2024, janë marrë 210 vendime përfundimtare me gjobë për shkelje të dispozitave ligjore, kryesisht në bazë të Kodit të Punës dhe ligjit nr. 10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Shkeljet më të shpeshta lidhen me nenet mbi domosdoshmërinë dhe mënyrën e pagesës, pagën minimale, formën e kontratës së punës, punën në ditë pushimi, përlllogaritjen e pagesës dhe masat mbrojtëse për punëmarrësit. Për sigurinë dhe shëndetin në punë, shkeljet kanë përfshirë detyrimet e punëdhënësve për parandalimin e aksidenteve dhe raportimin e tyre. Në 100% të rasteve, subjektet kanë marrë dijeni për vendimet e inspektimit, duke i shndërruar ato në tituj ekzekutivë, një rezultat që reflekton transparencë dhe efektivitet në komunikimin me subjektet. Për më tepër,

73% e vendimeve janë njoftuar përmes dorëzimit personal, duke siguruar një komunikim më të drejtpërdrejtë dhe efikas me subjektet.

Tipologjia e shkeljes që është sanksionuar me gjobë:

- 57% shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 7961, datë 1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.
- 18% shkelje të dispozitave të Ligjit nr.10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.
- 12% shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 9634/2006 “Për Inspektimin në punë” i ndryshuar.
- 4.4% shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 9136 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ne RSH”, i ndryshuar.
- 2.6% shkelje të dispozitave të VKM nr.562 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës”.
- 0.8% shkelje të dispozitave të VKM nr.564 “Për miratimin e Rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”.
- 3% shkelje të dispozitave të VKM nr.312 “Për miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantier” e ndryshuar.
- 0.8% shkelje të dispozitave të VKM NR.101, datë 23.02.2018 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencive Private të Punësimit”.
- 0.8% shkelje të VKM 1012 “Per sinjalistiken në kantier dhe në vendin e punës”.

Administrimi i Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së

Pranueshmëria dhe dakortësia me vendimet e inspektimit tregojnë për një tendencë pozitive në zbatimin e tyre. Mbajtja e të njëjtës kurbë në ulje për vitin 2024 të vendimeve përfundimtare të ankimuara administrativisht, si dhe ulja e ankimimeve ndaj vendimeve me gjobë, tregon për një rritje të besimit të subjekteve në procesin e vendimmarrjes dhe për një përmirësim të komunikimit dhe transparencës nga ana e institucionit. Ankimimi i 21% të vendimeve me gjobë në vitin 2024 është një shifër mjaft e ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Në vitin 2020, kjo shifër ishte 64%, në vitin 2021 ishte 36%, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 ishte 30%, duke treguar për një trend të qëndrueshëm drejt uljes së numrit të ankimimeve. Kjo tregon për një përmirësim të pranueshmërisë së vendimeve dhe për një marrëdhënie më të mirë të subjekteve me institucionin. Nga regjistri i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së rezulton se për vitin 2024, janë shqyrtuar 53 ankimime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit, nga të cilat 44 janë vendime me dënim administrativ gjobë, 3 janë vendime me dënim administrativ paralajmërim dhe 6 janë vendime vetëm me detyra të lëna. Vendimarrja e trupës kolegjiale për akmimimet e ushtruara për vitin 2024 është kryer brenda afateve ligjore, ku është vendosur për **46 vendime inspektimi lënia në fuqi, 7 vendime inspektimi janë ndryshuar** (në 6 vendimarrje është vendosur për ndryshim të llojit të dënimit nga gjobë në paralajmërim, në 1 rast për ulje të vlerës së gjobës, në 1 rast heqje të detyrës) dhe *shfuqizime kanë qënë zero*. Përmirësimi i punës inspektuese reflektohet edhe në faktin që asnjë vendim inspektimi nuk është shfuqizuar nga Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së, njësoj si në vitin 2023, ku krahasuar me vitin 2022, ka pasur 1 rast të tillë. Vetëm 20 vendime të Komisionit të Ankimit janë ankimuar në Gjykatë, ku në 100% të çështjeve për të cilat gjykata është shprehur me vendim, është mbajtur në fuqi Vendimi i Inspektimit dhe i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së.

Ndjekia e proceseve gjyqësore

Spektori i Çështjeve Ligjore ka bërë përfaqësimin ligjor në 50 procese gjyqësore, nga të cilat 49 janë ankime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit dhe 1 çështje me objekt ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga stafi i SHPSHSH-së. Në ato procese që ka një vendim nga gjykata është vendosur:

- Në 24 çështje rrëzimin e kërkesë-padisë, ku SHPSHSH është gjyq-fituese, të cilat janë të formës së prerë.
- Në 3 çështje pranimin e kërkesë-padisë, SHPSHSH ka humbur procesin duke rrëzuar 2 vendime përfundimtare të inspektimit të viteve të shkuara dhe 1 çështje me objekt ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të stafit të SHPSHSH-së, ndër të cilat 2 vazhdojnë në shkallë të dytë.
- 23 çështje janë në gjykim.

Rezultati që **në 89 %** të rasteve gjykata ka vendosur SHPSHSH si palë fituese, (krahasuar me 77% të vitit 2023) tregon për një punë të mirë në përgatitjen dhe mbrojtjen e çështjeve gjyqësore nga ana e Spektorit të Çështjeve Ligjore dhe e ekipit të inspektorëve të punës. Rritja e cilësisë së procesit të inspektimit dhe e vendimarrjes së Komisionit të Ankimit të SHPSHSH-së, asistencë juridike e dhënë inspektorëve të punës, kanë qenë faktorë të rëndësishëm në arritjen e këtij rezultati. Ndjekja me profesionalizëm e proceseve gjyqësore tregon për një përkushtim të fortë të institucionit për të mbrojtur të drejtat e tij dhe për të siguruar zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë.

Ekzekutimi i gjobave

Për vënien në ekzekutim të dënimeve administrative me gjobë, Spektori i Çështjeve Ligjore ka ofruar asistencë dhe ka bashkëpunuar ngushtë me Komisionin e Ankimit të SHPSHSH-së dhe Drejtoritë Rajonale. Ky bashkëpunim ka pasur një ndikim pozitiv në vijimin e procedurave të ekzekutimit të gjobave, duke siguruar që pas përfundimit të afatit të pezullimit të drejtës së ankimit administrativ, ekzekutimi i gjobave të vazhdojë sipas normimeve të legjislacionit në fuqi. Në vitin 2024, janë në proces të ndjekjes së ekzekutimit 100% të gjobave të vendosura, duke treguar një vullnet të qartë për zbatimin e vendimeve. Deri më tani janë likuaduar 46 % e gjobave të vitit 2024, me një vlerë prej 17,370,000 lekë, duke shënuar rritje nga viti 2023 ku likuadimi i gjobave ishte në masën e 41%. 45% e gjobave janë likuaduar vullnetarisht nga subjektet me 10% më shumë se një vit më parë duke reflektuar përmirësimin cilësor të vendimmarrjes së inspektorëve. Po ashtu, është vazhduar edhe me ekzekutimet e gjobave të viteve të shkuara, duke arkëtuar gjatë vitit 2024, 65 gjoba një vlerë prej 18,392,000 lekë në buxhetin e shtetit. Ndërkohë mesatarja e likuadimit të gjobave ndër vite është 75% e masave dhe vlerës së tyre. Kjo tregon për një përgatitje të mirë dhe për një angazhim të vazhdueshëm për zbatimin e ligjit dhe për respektimin e vendimeve të inspektimit nga institucioni.

Spektori i Financës

Buxheti i shtetit është instrumenti financiar kryesor për zbatimin e politikave dhe objektivave, ku pasqyrohen në mënyrë sistematike financiare të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit për një periudhë të caktuar. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore financohet tërësisht nga buxheti i shtetit dhe vlera në total e akorduar për vitin 2024 ka qënë 263,305 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre milion e treqind e pesë mijë) Lekë. Fondet buxhetore të çelura janë të detajuara në zërat e pagave (70%), sigurimeve shoqërore e shëndetësore (12%), mallra shërbime

(14%) dhe investime (4 %). Në kuadër të pavarësisë së menaxhimit të buxhetit, por edhe në zbatim të transparencës mbi përdorimin e fondeve buxhetore, bazuar në ligjin Nr. 97/2023 “Për buxhetin e Vitit 2024”, udhëzimin Nr. 9, Datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 1, Datë 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Aktit Normativ Nr. 5, Datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime në ligjin 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, ju paraqesim realizimin e fondeve buxhetore për periudhën **Janar – Dhjetor 2024** sipas zërave buxhetorë:

<u>Kodi</u>	<u>Emërtimi</u>	<u>Buxheti 2024</u>	<u>Plani 12-mujor</u>	<u>Fakti12-mujor</u>	<u>Realizimi %</u>
600+601	Paga & Sigurime	219,600	194,500	194,325	88.5%
602	Mallra Shërbime	32,457	32,457	32,449	100%
231	Investime	10,000	10,000	8,376	84%
606	Fondi i veçantë	1,248	1,248	1,223	98%
	TOTALI	263,305	238,205	236,373	90%

Realizimi i buxhetit për vitin 2024 në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është në masën **90%**, rezultat që ka ardhur për shkak të problematikave procedurale të hasura gjatë vitit 2024 në realizimin e shpenzimeve kapitale, konkretisht në projektin Blerje Automjete, për të cilin nuk u bë e mundur realizimi në masën 100%, pavarësisht angazhimit maksimal të institucionit për finalizimin e plotë të këtij projekti. Gjithashtu në zërin buxhetor Paga dhe Sigurime ku sipas aktit normativ të sipërcituar janë pakësuar fonde duke e ulur buxhetin e ISHPSHSH-së me 25, 100 Lekë, pakesim ky i ardhur si rrjedhojë e pozicioneve vakante që ka pasur institucioni gjatë 2024. Duhet theksuar se pavarësisht problematikave dhe sfidave përgjatë këtij viti ushtrimor realizimi total i buxhetit në masën 90% tregon një performancë pozitive të institucionit mbi menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore. Investimi në blerjen e automjeteve përbën një faktor shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës të ISHPSHSH. Ashtu siç edhe është parashikuar në vitin pasardhës, ISHPSHSH ka domosdoshmëri forcimin e kapaciteteve vecanërisht për aktivitetin kryesor të saj që është inspektimi i subjekteve private e publike në Republikën e Shqipërisë. Investimet e realizuara gjatë këtij viti në automjete, pajisje informatike, mobilje, mbarvajtje të zyrave të institucionit kanë ndihmuar në përmirësimin dhe plotësimin e nevojave të trupës inspektuese për të kryer punën e tyre me cilësi dhe efektivitet. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht duke përmirësuar logjistikën e institucionit dhe investuar në vitet pasardhëse me mjete pune shtesë dhe çdo burim të nevojshëm për realizimin e qëllimit parësor të ISHPSHSH-së që është procesi inspektimit në kohë dhe me cilësi.

Në të ardhurat e institucionit përfshihen edhe të ardhurat dytësore, të cilat përbëhen kryesisht nga gjrobat e ekzekutuara së bashku me kamat vonesat e tyre. Këto të ardhura për periudhën Janar-Dhjetor 2024 kapin vlerën 36,796,233 lekë, të detajuara si më poshtë:

- të ardhura nga gjrobat 35,302,010 lekë
- të ardhurat nga kamat vonesat 767,223 lekë
- të tjera* 727,000 lekë

	2023	2024	Dif
Të ardhura nga gjrobat	18,962,000 lekë	36,796,233 lekë	+100%
Realizimi i buxhetit	99%	90%	-9%

Të ardhurat që gjeneron Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nëpërmjet vendosjes së sanksioneve mbi subjektet publike dhe jo publike janë të ardhura që derdhen në buxhtin e shtetit.

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka si detyrë të garantojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ajo ka përgjegjësi për të kontrolluar dhe verifikuar zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në këtë fushë, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve të respektojnë standardet dhe procedurat e nevojshme për sigurimin e kujdesit dhe mbrojtjen e të drejtave të personave që marrin këto shërbime. Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka një rol kryesor inspektimin e ofruesve të shërbimeve, vlerësimin e standardeve për subjektet që duhet të liçensohen, inspektimin e ankesave dhe kërkesave të përfituesve dhe strukturave që mbrojnë të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, ajo përditëson dhe menaxhon një bazë të dhënash për shërbimet, subjektet, njësitë vendore, NjMF-të si dhe inspektimet e kryera. Ky proces ndihmon në sigurimin e standardeve të larta të shërbimeve shoqërore dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave që marrin këto shërbime.

Bazuar në këtë bazë të dhënave numri i shërbimeve, llojet e përkujdesit dhe aktorët janë në total rreth 500 shërbime, struktura dhe projekte që janë objekt ligjor kontrolli, informimi, verifikimi dhe vlerësimi të përmbushjes së treguesve të standardeve të përkujdesit. Të grupuara, këto shërbimet dhe aktorët, janë si më poshtë:

1. **118** shërbime të përkujdesit rezidencial dhe strehim emergjent, nga të cilat 41 janë publike, 3 partneritet;
2. **264** qendra/njësi të të përkujdesit komunitar, (qendra ditore, gjysmë ditore, shërbime emergjente, shërbime në familje, shërbime terapeutike të specializuara, linja të këshillimit telefonik, etj). Nga të cilat 85 klasifikohen shërbime publike apo në partneritet;
3. **70** projekte/shoqata në komunitet, shërbime parashoqërore, projekte dhe fushata për forcim kapacitetesh, advokasi, asistencë e specializuar (psh. ligjore, këshillim psikologjik), kontribute dhe përfshirje në menaxhim rasti, ndihma humanitare apo paketa ndihme emergjente;
4. **61** Drejtori/Sektorë/Zyra të kujdesit social në nivel bashkie, të cilat ofrojnë shërbim parashoqëror, vlerësim, referim dhe menaxhim rasti, pjesëmarrje dhe vendimmarrje në Planin e Përkujdesit (*Punonjësi Social, PMF, KVMVDHF, Administratori Shoqëror, etj*

Aktivitetet dhe Arrirtjet kryesore te Vitit 2024

Në mënyrë të përmbledhur, për secilin prioritet, treguesit e arritur gjatë vitit 2024 janë:

Nr	Prioriteti	Aktiviteti	Realizuar
1	Forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore.	Tryeza Teknike, Ëorkshop në nivel kombëtar për forcimin dhe promovimin e rolit të inspektoriatit të kujdesit shoqëror dhe rishikimi i standarteve të shërbimeve shoqërore.	6
2	Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet informimit, konsultimit dhe vlerësimit të strukturave dhe shërbimeve të reja.	Takime vlerësuese në Bashki/Qarku dhe aktorë të tjerë.	36
3	Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet Inspektimit të ofruesve të shërbimeve shoqërore.	Inspektime të qendrave të përkujdesit shoqëror.	126

Bazuar në përgjegjësinë ligjore dhe në synimin për garantimin e cilësisë së përkujdesit të ofruar nga subjekte publike dhe jopublike, Drejtoria, përgjatë vitit 2024, ka realizuar programin e punës së saj, drejtuar nga 2 prioritetet: 1).Forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore dhe 2) Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet informimit, konsultimit dhe ofrimit të ekspertizës për rishikimin dhe hartimin e standarteve të shërbimeve shoqërore të tipologjive të reja.



Gjatë vitit 2024, në bazë të Ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.512 datë 31.5.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të shërbimeve shoqërore”, Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka realizuar 126 kontrolle dhe vlerësime mbi standardet e përkujdesit në qendrat/njësitë e shërbimeve të kujdesit social. Nga këto, 122 ishin të planifikuara dhe 4 jashtë planit mujor, përfshirë 3 kontrolle të nisura nga ankesa dhe 1 për procedurë licencimi. Kontrollat janë realizuar në përputhje me prioritetin e garantimit të cilësisë së shërbimeve nga aktorët publikë dhe jopublikë, duke siguruar përmbushjen e standardeve të përcaktuara ligjërisht. Këto kontrolle janë grupuar sipas objektivave dhe indikatorëve të planifikimit për të siguruar një monitorim efektiv dhe të detajuar si më poshtë:

Nr.	Treguesi			Realizuar
1	Inspektime të planifikuara të Qendrave/Sh të përkujdesit social			122
	1.1	<i>Qendra përkujdesi (publike dhe jopublik), të planifikuar mbi bazë historiku</i>		37
	1.2	<i>Qendra përkujdesi të mbështetura me Fond Social në vijimësi</i>		34
	1.3	<i>Qendra përkujdesi të mbështetura me Fond Social për here të parë</i>		14
	1.4	<i>Qendra përkujdesi të mbështetura nga Bashkitë, (Indikator 4 IPA II)</i>		19

1.5	Qendra për fëmijë në kuadër të Bashkëpunimit me Min. e Arsimit	18
2	Inspektime të paplanifikuara (ankesa dhe licensime)	4
3	Inspektime gjithsej	126

Në praktikën e 4 viteve të fundit, për 6 mujorin e parë të vitit, prioriteti i veprimtarisë inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, është kontrolli i Qendrave/Shërbimeve të kujdesit shoqëror të mbështetura me Fond Social në vitin pararendës. Ndërsa në muajin Korrik fillon procesi i vlerësimi i shërbimeve të kujdesit komunitar në bashki, në funksion të raportimit pranë Delegacionit Europian për plotësimin e Indikatorit të IPA II Mbështetje Financiare “Përfshirja Sociale”. Planifikimi dhe realizimi i kontrollit të Qendrave/Shërbimeve të mbështetura me Fond Social ka ndikuar edhe në strukturën e llojeve të Qendrave/Shërbimeve të kontrolluara. Kështu, me Fond Social janë mbështetur shërbime publike komunitare, numri i të cilave rritet për çdo vit, dhe për rrjedhojë dhe janë inspektuar më shumë Qendra Publike të Përkujdesit Komunitar.

Për ilustrim, në grafikët e mëposhtëm paraqiten: 1- ecuria në numër dhe tipologji të Qendrave/Shërbimeve të mbështetura me Fond Social dhe 2 – raporti i midisi subjektet publike dhe jopublike të kontrolluara.



Në lidhje me tipologjinë e përkujdesit, gjatë vitit 2024, Drejtoria ka ruajtur një balancë të qëndrueshme midis inspektimeve të shërbimeve komunitare dhe atyre të përkujdesit rezidencial, duke siguruar që shërbimet rezidenciale të mos anashkalojnë për shkak të zgjerimit të shërbimeve komunitare. Inspektimet e shërbimeve komunitare kanë mbetur në një nivel mesatar të tre viteve të fundit, pavarësisht rritjes së numrit të tyre. Për vitin 2024, është planifikuar me kujdes mbulimi i të gjitha tipologjive të qendrave dhe shërbimeve, duke reflektuar një rritje prej 7% të

inspektimeve në shërbimet e përkujdesit rezidencial dhe në numrin total të inspektimeve krahasuar me një vit më parë.

Tipologjia e Shërbimit	2022	2023	2024
Qendrat e përkujdesit rezidencial të inspektuara	25 %	20 %	27 %
Qendra/shërbime e përkujdesit komunitar të inspektuara	63 %	69 %	66 %
Qendra/shërbime emergjente të inspektuara	12 %	9 %	7 %

Për vitin 2024, specifikë lidhur me inspektimet e shërbimeve të përkujdesit komunitarë është edhe inspektimi i subjekteve jopublike në kuadër të **Bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve**, për verifikimin dhe kontrollin e subjektetev me veprimtarinë në fushën e arsimit parashkollor dhe të pajisuar me liçensë në fushën përkujdesit komunitar, (Kodi X.1.A), sipas listës së sjellë nga QKB. **Kështu, u planifikuan dhe u realizuan 18 inspektime të këtyre subjekteve, (të quajtura kopshte).**

a) Sanksionime të subjekteve për vitin 2024

- ✓ 4 masa administrative “Propozim për Revokim liçense”

Për vitin 2024 është dhënë si masë kryesore administrative “Propozim për Revokim license” për 4 subjekte jopublike, të licensuara për shërbime të kujdesit komunitar, të cilët u konstatuan që ofrojnë shërbime të fushës së arsimit parashkollor për fëmijë të grupmoshës 3-5 vjeç dhe jo shërbime të përkujdesit social.


b) Masa administrative plotësuese

- ✓ 2 propozime për lirim nga detyra për mungesë të arsimit përkatës
- ✓ 243 detyra me afate

Nga kontrolli në **126 Qendra/Shërbimet u konstatua** se, përgjithësisht, janë plotësuar kërkesat proceduriale dhe treguesit e standarteve. Me përjashtim të 4 rasteve të veprimtaisë jashtë fushës së liçensimit, (kopshtet), në Qendrat/Shërbimet e tjera nuk janë konstatuar shkelje ligjore por mangësi në plotësimin e treguesve të veçantë të standarteve përkatëse të miratuara. Kështu në aspektin numerik, **në tërësi janë lënë 243 rekomandime/detyra me afate**, nga të cilat:

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025 NGA DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

1. **Forcimi i kapaciteteve inspektuese.** Kontribut dhe pjesmarrje në procesin e përmirësimit i akteve nënligjore që përfishin paketën e akteve nënligjore që lidhen me aspektet dhe instrumentet teknike të inspektimit, si edhe të standarteve të përkujdesit sipas tipologjive të përkujdesit.
2. **Përmirësimi i cilësisë së përkujdesit dhe promovimi i rolit të Inspektoriatit.** Nxitja dhe ndërgjegjësimi i strukturave vendore programuese dhe administruese të shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet Vlerësimit, Informimit dhe këshillimit të tyre t’u përgjigjur të gjitha grupeve në nevojë me profesionistë, procedura dhe shërbime.
3. **Garantimi i cilësisë së përkujdesit nëpërmjet inspektimit.** Për garantimin e cilësisë së përkujdesit për individët në nevojë në Qendrat/shërbimet ekzistuese dhe të reja, vendos si target vjetor realizimin e 120 inspektimeve dhe vlerësimeve të plotësimin të standarteve të përkujdesit shoqëror në Qendra/Shërbime publike dhe jopublike, bazuar në standartet përkatëse të miratuara.



AKTIVITETE DHE PUBLIKIME



6. AKTIVITETE DHE PUBLIKIME

Komunikimi dhe informimi publik janë elementë kyç për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), duke siguruar transparencën dhe ndërtuar marrëdhënie të drejtpërdrejta me publikun lidhur me aktivitetin e institucionit. Përmes përdorimit të mjeteve, kanaleve dhe platformave të ndryshme të komunikimit, ISHPSHSH informon dhe ndërgjegjëson punonjësit dhe punëdhënësit mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë për një mjedis të sigurt dhe të denjë. Përveç ndërgjegjësimin gjatë procesit inspektues, ISHPSHSH i kushton rëndësi të veçantë aktiviteteve të ndryshme, si prezantime, tryeza të rumbullakta dhe marrëveshje ndërinstitucionale, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të punës së institucionit dhe përmbushjen e misionit të tij. Aktivitetet kryesore të ISHPSHSH komunikohin në mënyrë efektive gjithashtu në kalanlet digjitale të institucionit sic janë faqja ëeb-it ëëë.inspektoratipunes.gov.al, Facebook dhe Intagram.

Fushatat ndërgjegjësuere kryesore gjatë vitit 2024 kanë qenë:

- Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuere për 28 Prill, “Ditën Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, ISHPSHSH ka përgatitur dhe shpërndarë 4000 fletë-palosje informuese në të gjithë Shqipërinë. Kjo iniciativë u realizua për të përkujtuar këtë ditë dhe veçanërisht “Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Punëtorëve të Aksidentuar”, duke angazhuar të gjithë trupin inspektues në përhapjen e informacionit dhe promovimin e rëndësisë së sigurisë dhe shëndetit në punë.

FLETË-INFORMUESE

28 Prilli është Dita Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Inspektorati Shtetëror i Punës nat krijimin e kulturës parandaluese për sigurinë dhe shëndetin në punë. Të gjithë ne, si punonjës, punëdhënës, dhe autoritetet përgjegjëse, kemi detyrimin për të garantuar që vendi i punës të jetë një ambient i sigurt dhe shëndetshëm për të gjithë.

SI TË REDUKTONI AKSIDENTET NË VENDIN E PUNËS

Parandalimi i aksidenteve në vendin e punës është një çështje kritike për të gjithë sektorin e punës. Shtetet e bashkuara dhe parandalimi i rezeve në burim janë thelbësore për reduktimin e tyre. Dialogu social, partneriteti dhe përfaqja e punëtorëve janë të domosdoshme për të siguruar një ambient pune të sigurt.

Ndërgjegjësimi dhe informimi.
Fushatat e ndërgjegjësimit, përfaqja në trajnime dhe materiale informuese kanë një impact të ndjeshëm në sjelljen dhe kujdesin e punonjësve në lidhje me rezeve në ambientin e tyre të punës. Studimet tregojnë se një ndërgjegjësim i mirë dhe informacion i vazhdueshëm mund të sjellë një reduktim deri në 10% të aksidenteve në punë.

Këshillimi i drejtpërdrejtë me kompaninë.
Një mjet efektiv për të ulur deri në 25% shkallën e aksidenteve në vendin e punës. Inspektorati e Punës kanë një rol kyç në këtë drejtim, duke ofruar inspektime këshilluese dhe informuese të cilat ndihmojnë në identifikimin e rezeve të mundshme dhe në hartimin e masave parandaluese.

Sistem Monitorimi.
Një sistem monitorimi i fortë është thelbësor për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës pasi ndihmon në identifikimin, vlerësimin e rezeve në mënyrë efektive, analize të thelluar dhe statistika për identifikimin e rezeve specifike.

Dialogu social, partneriteti dhe përfaqja e punëtorëve.
Dialogu social ndërmjet punëdhënësve, punonjësve, sindikatave dhe shoqatave të punëdhënësve synon të sigurojë një partneritet të ndërgjegjshëm dhe të drejtë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Përfaqja e punëtorëve në këtë dialog është e rëndësishme për të identifikuar rezeve për edhe për të arritur një konsensus më të gjerë në zbatimin e masave dhe politikave parandaluese.

www.inspektoratipunes.gov.al

Përshatja e masave me mjedisin e ndërmarrjes ose industrisë.

Mjaft e rëndësishme është që masat e parandalimit të jenë të përshtatshme për rrethanat e veçanta të mjedisin e punës. Një ndihmë e rëndësishme mund të vijë nga këshillat teknike ose trajnimet për identifikimin e rezeve specifike.

VLERËSIMI I RISKUT Rrethet e Përgjegjësitë

Ligji i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë ka për qëllim të garantojë Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, nëpërmjet parandalimit të rezeve, eliminimit të faktorëve që përbejnë rrethet për aksidentet, këshillimit, përsëritjes dhe informimit të punëtorëve të përfaqësuesve të tyre. Faktorët kryesorë për një ambient pune të sigurt e të shëndetshëm janë:

- Punëtarësitë e informuar dhe të konsultuar;
- Dokumenti i Vlerësimit të Riskut;
- Efektiviteti i Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë;
- Personi përgjegjës për qendrën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Mjeksi i ndërmarrjes.

Vlerësimi i riskut është themelor për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe për të garantuar një ambient pune të sigurt nevojitet një ekspertizë i thelluar në të gjitha aspektet siç janë:

- Identifikimi i rezeve të mundshme për Shëndetin dhe Sigurinë në vendin e Punës;
- Vlerësimi i riskut për të përcaktuar nivelin e rrezikshmërisë për çdo proces;
- Verifikimi e prioritetit për të adresuar rezeve më të rëndësishme dhe urgjente;
- Zhvillimin e planeve dhe masave për të kontrolluar dhe zvogëluar rezeve;
- Rishikimin periodik të vlerësimit të riskut për të garantuar efektivitetin e masave.

www.inspektoratipunes.gov.al

Kush bën çfarë?

Punëdhënësi ka për detyrë:

- Të garantojë sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në çdo aspekt që lidhet me punën;
- Të organizojë vlerësimin e riskut dhe zbatimin e masave mbrojtëse;
- Të zgjedhë personin për të kryer vlerësimin e riskut;
- Konsultohet me punonjësit ose përfaqësuesit e tyre në lidhje me organizimin e vlerësimit të riskut;
- Të sigurojë që të gjithë punonjësit të jenë të informuar për çdo rrethet dhe masat mbrojtëse.

Punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë/detyrë që:

- Të marrin pjesë në vlerësimin e riskut;
- Paralajmërojnë mbikëqerësit ose punëdhënësit e tyre për rezeve e perceptuar;
- Të informohen për rezeve dhe për masat e nevojshme për eliminimin ose reduktimin e tyre;
- Të propozojë masa për të minimizuar rezeve ose për të eliminuar rezeve në burim;
- Të bashkëpunojnë për të mundësuar punëdhënësit të sigurojë një mjedis të sigurt pune.

www.inspektoratipunes.gov.al

- Fushata Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023-2025, nën sloganin “Vende Pune të Shëndetshme, në Epokën Dixhitale”, e udhëhequr nga Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (EU-OSHA), ISHPSHSH, në bashkëpunim me MEKI, ka organizuar një sërë aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin mbi ndikimin e teknologjive dixhitale në vendin e punës dhe menaxhimin e këtyre ndryshimeve. Aktivitetet përfshinë vizita në subjekte, takime sensibilizuese dhe tryeza të rumbullakta me pjesëmarrjen e punëdhënësve, punëmarrësve, sindikatave dhe organizatave të fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjatë fushatës, e gjithë trupa inspektuese kreu vizita në 36 subjekte ndërtimi, duke informuar 1050 punëmarrës, si dhe në 45 subjekte të tjera në sektorë si prodhimi, call-center dhe shërbimet, ku automatizimi dhe teknologjitë dixhitale kanë marrë një rol të rëndësishëm, duke informuar 2987 punëmarrës për sigurinë dhe shëndetin në punë në epokën dixhitale. U zhvilluan takime ndërgjegjësuere u organizuan në 18 shkolla të Formimit Profesional ku u informuan 1716 nxënës të këtyre

shkollave. E gjithë trupa inspektuese ka ushtruar vizita inspektuese në 36 subjekte ndërtimi ku u informuan 1050 punëmarrës.



- **17,501** subjekte ekonomike të reja e të sapo rregjistruara në QKB, janë informuar nëpërmjet platformës "e-albania" mbi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni i punës
- Rreth **166** postime në rrjetet sociale dhe mbi 13 prezencë televizive për të ndergjegjesuar publikun mbi punën e denjë, sigurinë dhe shëndetin në punë.

Konferenca, Takime dhe Tryeza të Rumbullakëta

Me mbështetjen e Agjencisë Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA) organizoi seminarin me temë: “Rritja e ndërgjegjësimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në koherencë me strategjitë e BE-së”, me pjesëmarrës të organizatave të punëdhënësve, punëmarrësve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë që operojnë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Qëllimi i seminarit të ndërgjegjësojë dhe të promovojë një kulturë dhe mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke përqëndruar veçanërisht në zvogëlimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Realizimi i këtij qëllimi është i lidhur ngushtë me Planin e Veprimit të Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë për periudhën 2024-2030



Sesionin e 76-të të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR) në Kombet e Bashkuara për shqyrtimin e Raportit të IV periodik të Shqipërisë mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.



Pjesëmarrja në Takimin Hapës të Projektit ESAP 3 që u zhvillua në Budva. Takimi mbledhi përfaqësues nga Ministrinë e Ballkanit Perëndimor përgjegjëse për çështjet e punës dhe sociale, inspektoratet e punës, shërbimet publike të punësimit, partnerët socialë dhe Bashkimin Evropian. Gjatë takimit, Shqipëria prezantoi arritjet dhe sfidat në luftën kundër informalitetit, duke theksuar edhe zhvillimet teknologjike të avancuara si Matrica e Inspektimeve dhe Vlerësimit të Rrezikut. Prezantimi gjithashtu përfshiu zhvillimin e inspektimeve të zgjuara duke u mbështetur në sisteme dixhitale të fuqizuar nga Inteligjenca Artificiale si Data Mining dhe Machine Learning, për të automatizuar planifikimin e inspektimeve të bazuara në rrezik. Kjo pjesëmarrje reflekton përkushtimin e Shqipërisë për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe për të avancuar drejt përafrimit me standardet e punës të BE-së.



Inspektorati Shtetëror i Punës së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), morën pjesë në eventin e përvitshëm të organizuar nga ERMC në bashkëpunim me Ambasadën Greke. Tema e këtij viti ishte “Dimensioni Njerëzor, Siguria dhe Teknologjia”. ISHPSHSH prezantoi qasjen e Inspektoratit të Punës, duke integruar zhvillimet e




reja teknologjike në inspektimet e përditshme dhe përmes përdorimit të platformave dixhitale të kryejë inspektime të zgjuara bazuar në analizë të riskut për të siguruar efikasitetin në zbatimin e Legjislacionit të Punës. Ndërkohë, përfaqësuesi i MEKI-it prezantoi Dokumentin Politik të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 2024-2030, duke theksuar qëllimet, objektivat dhe sfidat për zbatimin e tij. Sfidat kryesore mbeten përfshirja gjithëpërfshirëse e aktorëve të fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë.

Takimi i përfaqësuesve të Unionit për Mesdheun (UfM) të Shteteve joanëtare të BE-së, pranë zyrave qendrore të ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) në Gjenevë, Zvicër. Kryeinspektori Z. Eljo Mucaj, gjatë një vizite 2 ditore pranë zyrave qendrore të ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) në Gjenevë, Zvicër, mori pjesë në takimin e përfaqësuesve të shteteve anëtare të Unionit për Mesdheun (UfM). Gjatë këtij takimi u diskutuan disa çështje të lidhura me punën ku më kryesoret ishin funksionimi i ILO-s, vështrimi i përgjithshëm i temave kryesore të Trupit Drejtues të ILO-s (GB) dhe Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILC), gjendja aktuale e ratifikimeve të Konventave të ILO-s, Shëndeti dhe Siguria në Punë, Sigurimet Shoqërore, Dialogu Social, etj.

Forumit e 2-të Ndërkombëtar Teknik të Zyrtarëve të Lartë të Inspektorateve të Punës, i cili u zhvillua më 24-25 Shtator 2024 në Trondheim, Norvegji. Ky forum i cili organizohet në bashkëpunim nga ILO dhe Ministria e Punës dhe Përfshirjes Sociale të Norvegjisë është në përputhje me objektivat e ILO-së, të cilat synojnë forcimin e kapacitetit institucional të Inspektorateve të Punës. Fokus në sigurimin e zbatimit të Udhëzimeve mbi Parimet e Përgjithshme të Inspektimit të Punës, së bashku me parime dhe standarde të tjera të ILO-së që lidhen me qeverisjen e inspektimit të punës.



Pjesmarrja në Platformën e 17-të Rajonale të Unionit për Mesdheun (UfM) për Punësimin dhe Punën, duke prezantuar përparimin e bërë në zbatimin e "Deklaratës së Marakeshit". Përfaqësuesit e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) prezantuan zhvillimet kryesore dhe theksuan se si Shqipëria zbaton me sukses Deklaratën e Marakeshit të UfM 2022. Ata ndanë përvojën mbi pilotimin e Programit të Garancisë Rinore, një nismë e rëndësishme që ka luajtur një rol thelbësor në mbështetjen e punësimit të të rinjve si dhe gjithashtu prezantuan përpjekjet dhe arritjet e institucioneve shqiptare me fokus të qartë për të garantuar vende pune të denja dhe mundësi të barabarta ekonomike për të gjithë punëtorët në Shqipëri.




Konferenca në kuadër të programit "Fuqizimi i Politikave për Orientimin e Migracionit drejt Zhvillimit" (MEG) dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore mori pjesë në konferencën, "Promovimi i Rekrutimit të Drejtë dhe Zbutja e Kushteve të Pasigurta të Punës për Punëtorët Migrantë në Ballkanin Perëndimor", zhvilluar në 26-27 nëntor 2024. Event u organizua në partneritet me



Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), me mbështetjen e institucioneve partnere lokale në Kosovë, përfshirë Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (EARK) dhe Inspektoratin e Punës (IP).

Regional Tripartite Knowledge Sharing Forum for Europe and Central Asia organizuar në Stamboll nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë për të diskutuar qasje inovative në adresimin e informalitetit dhe promovimin e kalimeve drejt formalitetit në rajon. Inspektorati Shtetëror i Punës pati privilegjin të prezantojë sistemin MIRA – Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Rrezikut, një platformë inovative e bazuar në teknologji të avancuara të Inteligjencës Artificiale, si data mining dhe machine learning, që ka transformuar mënyrën e realizimit të inspektimeve në Shqipëri.





Inspektorati
Punës

**SFIDA
TË HASURA**

7. SFIDA TË HASURA

Gjatë vitit 2024, Inspektorati i Punës është përballur me një sërë sfidash të rëndësishme që kanë ndikuar në dinamikën e inspektimeve dhe përmbushjen e misionit të tij. Disa nga sfidat kryesore përfshijnë:

- **Ndërgjegjësimi dhe nxitja e një kulture më të thelluar mbi sigurinë dhe shëndetin në punë** dhe respektimin e ligjit ka kërkuar përpjekje të vazhdueshme përmes fushatave të informimit dhe trajnimeve për punëdhënësit dhe punëmarrësit.
- **Forcimi i kapaciteteve inspektuese:** Sigurimi i mjeteve të nevojshme, përmirësimi i logjistikës dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara për inspektorët ka qenë një sfidë e vazhdueshme. Kjo është një nevojë kritike për të rritur cilësinë dhe efektivitetin e inspektimeve, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë si ndërtimi, minierat dhe shërbimet.
- **Zgjerimi i subjekteve të inspektuara për herë të parë:** Një objektivi kryesor ka qenë inspektimi i subjekteve që nuk janë përballur më parë me kontrole, duke zgjeruar kështu mbulimin dhe garantimin e përputhshmërisë ligjore në sektorë të ndryshëm.
- **Inspektimi i subjekteve me punëmarrës të huaj:** Sigurimi i respektimit të të drejtave të punëmarrësve të huaj ka qenë një nga prioritetet, me fokus në eliminimin e diskriminimit dhe sigurimin e kushteve të drejta të punës. Gjatë vitit 2024 është shënuar një rritje prej 14% e numrit të punëmarrësve të huaj të konstatuar, duke kërkuar një mbikëqyrje më intensive të këtij segmenti të tregut të punës.
- **Monitorimi i kategorive të veçanta të punëmarrësve:** Një vëmendje e veçantë është kushtuar mbikëqyrjes së subjekteve që punësojnë të mitur nën 18 vjeç, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me dispozitat ligjore dhe mbrojtjen e kësaj kategorie punëmarrësish nga shfrytëzimi apo rrezikimi i mirëqenies së tyre.
- **Plotësimi i pozicioneve vakante për inspektorët e punës:** Aktualisht, 7 inspektorë rajonalë janë në vakancë, një faktor që ndikon në frekuencën dhe mbulimin e inspektimeve. Kjo sfidë kërkon një proces të shpejtë rekrutimi dhe trajnimi për të siguruar vazhdimësinë dhe efikasitetin e inspektimeve.
- Adresimi i këtyre sfidave mbetet prioritet për ISHPSHSH në vitet në vijim, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes dhe zbatimit të standardeve të punës në Shqipëri.

OBJEKTIVAT KRYESORE



8. OBJEKTIVAT KRYESORE

Inspetimet e zgjuara mbështetur në një planifikim me bazë risku, ndërgjegjësimi, rritja e bashkëpunimit, komunikimit dhe këshilimi punëdhënësve dhe punëmarrësve kanë qënë 5 objektivat kryesore të përcaktuara për vitin 2024 mbi të cilat do të vazhdojnë të jenë pilarët kryesore të punës së ISHPSHSH edhe gjatë vitit 2025. Puna inspektuese përmes platformës digjitale MIRA do të këtë fokusin kryesor të ISHPSHSH-së gjatë këtij viti duke rritur standartin e cilësisë së inspektimit, me qëllim dhënien e kontributit real në përmirësimin e tregut të punës. Promovimi i kulturës parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe productive do vijojë të kryhet duke shfrytëzuar të gjithë burimet dhe kapacitetet institucionale, pasi jep ndikim pozitiv në aspektin parandalues për rreziqet në punë dhe adresim problematikash për të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji. Përbushja e detyrimeve institucionale për raportim në kuadër të procesit të integritetit në BE është gjithashtu një qëllim i rëndësishëm. Kjo përfshin pjesëmarrjen në zhvillimin e strategjive ndersektoriale dhe sektoriale, që do të ndihmojnë në përmirësimin e standardeve të punës në Shqipëri dhe përbushjen e kritereve për anëtarësim në BE. Këto objektiva tregojnë një qasje të qartë drejt modernizimit dhe përmirësimit të inspektoratit të punës në Shqipëri, duke u përqëndruar në zbatimin e standardeve të larta të punës dhe sigurisë në vendet e punës, si dhe në rritjen e profesionalizmit dhe etikës institucionale.

Objektivi Nr. 1: Përmirësimi i Cilësisë së Procesit të Inspektimit

- Automatizimi i planifikimit të inspektimeve me bazë risku: 75% e planifikimeve realizohen përmes sistemit MIRA, duke përdorur analizën e riskut.
- Monitorimi dhe raportimi: Konsolidimi i monitorimit të aksidenteve, ankesave dhe objektivave përmes raporteve tremujore dhe analizave të performancës në nivel sektori, rajoni apo inspektori të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në vlerësimet e punës së secilit
- Përmirësim të vazhdueshëm të indikatorëve të analizës së riskut përmes analizave të thelluara Përmirësim i indikatorëve të riskut për sektorë me prioritet (Ndërtimi, Turizmi, SHRSF, Media, Delivery, etj.), duke projektuar fushata këshilluese dhe inspektuese.
- Zhvillimi i Listave të Verifikimit. Janë përditësuar dhe publikuar listat e verifikimit (Check-lists) për sektorë të ndryshëm.
- Zhvillimi i raporteve të automatizuara në sistemet MIRA dhe e-inspection, që përfshijnë vlerësime në nivel rajoni, inspektori dhe sektori ekonomik.
- Inspektime tematike: Realizimi i inspektimeve për sektorë me risk të lartë (ndërtim, agjenci punësimi, turizëm) me urdhër të posaçëm nga Kryeinspektori dhe Ministri.

Objektivi Nr. 2: Digjitalizimi

- Përfundimi i fazës pilot për MIRA dhe përmirësim i vazhdueshëm i sistemit për mundësuar një proces planifikimi sa më cilësor dhe efektiv.
- Përmirësime të integruara në sistemin e-inspection. Janë implementuar disa nga ndryshimet e propozuara nga ISHPSHSH në bashkëpunim me Inspektoratin IQ.
- Vlerësim i shërbimeve publike për deregulim dhe efikasitet institucional.

Objektivi Nr. 3: Ndërgjegjësimi

Ky objektivi synon promovim e një kulture parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe produktive, përmes rritjes së ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Janë organizua tre fushatave sensibiluese në nivel kompanie, rajonal / kombëtar me tematika, ku disa prej tyre do të vazhdojnë të zhvillohen edhe gjatë 2025.

- Vende Pune të shëndetshme, në Epokën Dixhitale.
- Në kuadër të Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të punëtorëve që janë aksidentuar me vdekje ose jo”,
- Migracioni i rregullt.
- Informimi me informacion mbi legjislacionin e punës për **16,396 subjektet të reja** që janë regjistruar gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me QKB në kuadër të marreveshjes
- Përdorimi me efektivitet i rrjeteve sociale duke zhvilluar fushata të dedikuara me fokus punën e denjë, sigurinë dhe shëndetin në punë.

Objektivi Nr. 4: Integrimi në BE

Ky objektivi synon përmbushjen e detyrimeve institucionale për raportim në kuadër të procesit të integritetit në BE. Gjatë vitit 2024 ISHPSHSH ka përmbushur detyrimin në raport me kontributin e kërkuar në kuadër të raportimit për Kapitujt ku bën pjesë, si 19, 20, 23, 2, 24; 28; FDI, Kriteri Ekonomik.

Objektivi Nr. 5: Integriteti dhe Etika Institucionale

Ky objektivi tregon një qasje të qartë drejt modernizimit dhe përmirësimit të inspektoratit të punës në Shqipëri, duke u përqëndruar në zbatimin e standardeve të larta të punës dhe sigurisë në vendet e punës, si dhe në rritjen e profesionalizmit dhe etikës institucionale. Në këtë drejtim është synuar forcimi i integritetit, rritja e profesionalizmit dhe etikës institucionale të ISHPSHSH-së, përmes:

- Rivlerësimi të indikatorit të performancës të punës së inspektorëve.
- Konsolidim i monitorimit të performancës së inspektorëve dhe analizave tremujore.
- Zhvillim i programeve të trajnimit me fokus teknikat e avancuara të inspektimit.
- Respektim i Planit të Integritetit dhe planit të menaxhimit të riskut.



**Inspektorati Shtetëror i Punës
dhe Shërbimeve Shoqërore**